

**VENDIM**  
**Nr. 00-2024-2155 (107), datë 24.4.2024**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

|               |           |
|---------------|-----------|
| Ilir Panda    | kryesues; |
| Medi Bici     | anëtar;   |
| Albana Boksi  | anëtare;  |
| Sandër Simoni | anëtar;   |
| Ervin Pupe    | anëtar,   |

sot në datë 24.4.2024, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen penale, që i përket:

**KËRKUESE:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*aktualisht Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*)

**TË GJYKUAR:** Lavdim Neziri (Nelaj), Lefter Nelaj, Bledar Baboçi (Noka ose Trokthi)

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 284/1, 28/4, 333/a-1 dhe 334/1 të Kodit Penal.

**TË GJYKUAR:** Elton Haxhiu, Hashim Nelaj, Sami Balloku, Astrit Tafaj, Aldo Xhaferri, Bajram Hidri

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 284/1, 28/4, 333/a-2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

**I GJYKUAR:** Bashkim Kodra

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal.

**KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,**

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Albana Boksi; prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Adnand Xholi dhe Ened Nakuçi, të cilët kërkuan: “*Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; Njësimin e praktikës gjyqësore*”; mbrojtësin e të pandehurve Elton Haxhiu, Hashim Nelaj, Lefter Nelaj dhe Lavdim Neziri, avokat Marash Ibraj, i cili kërkoj: “*Prishjen e vendimit nr. 29, datë 16.3.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, vendimit nr. 60, datë 12.6.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe pushimin e çështjes. Kërkesë alternative: Prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës se apelit. Lidhur me objektin për unifikimin e praktikës: Konfirmimin e qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese dhe KEDNJ për mosrëndimin e pozitës procedurale*”; mbrojtësin e të pandehurve Aldo Xhaferri dhe Astrit Tafaj, avokat Ali Paja, i cili kërkoj: “*ndryshimin e vendimit të të dyja gjykatave dhe deklarimin e pafajshëm të pandehurve pasi nuk ka asnjë provë*”; mbrojtësin e të pandehurit Bledar Baboçi, avokat Saimir Vishaj, i cili kërkoj: “*Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë*”; mbrojtësin e të pandehurve Bajram Hidri, Lavdim Neziri, Sami Balloku, avokat Sokol Kepi (i caktuar kryesisht), i cili kërkoj: “*Prishjen e vendimit penal nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, si dhe të vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe kthimin e akteve për rigjykim pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*”; mbrojtësen e të pandehurit Bashkim Kodra, avokate Sonila Çekrezi, e cila kërkoj: “*Pranimin e rekursit të të dënuarit Bashkim Kodra dhe pushimin e gjykimit*”; si dhe e bisedoi çështjen në tërësi, në përfundim,

**VËREN:**

## I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në kuadër të procedimit penal nr. 147, viti 2016, ka paraqitur para asaj gjykate për gjykim çështjen penale në ngarkim të pandehurve Lavdim Neziri (Nelaj), Lefter Nelaj, Bledar Baboçi, Elton Haxhiu, Hashim Nelaj, Astrit Tafaj, Sami Balloku, Bajram Hidri, Aldo Xhaferri, nën akuzën: “Kultivimi i bimëve narkotike”, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 284/1, 28/4, 333/a, 334/1 të Kodit Penal (në vijim “KP”). Gjykimi i kësaj çështje është zhvilluar sipas procedurës së gjyimit të shkurtuar, në gjendjen e akteve të fashikullit të hetimit paraprak, në përputhje me nenet 403 – 406 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim “KPP”).

2. Gjykatat e faktit, në gjykimin e çështjes me procedurën e gjyimit të shkurtuar, kanë pranuar këto rrethana të çështjes:

- Në datë 21.9.2016, në afërsi të banesës së të pandehurit Sami Blloku, u gjetën dhe u sekuestruan me cilësinë e provës materiale 35 kg, e 0.30 gram bimë narkotike e llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 22.9.2016, në fshatin Selitë. lagja “Daul”, në 9 parcela u gjetën të kultivuara 430 bimë narkotike të llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 21.9.2016, në vendin e quajtur Trollë, fusha e Mizajve, Mat. në 2 parcela u gjetën të mbjella dhe u asgjësuan 1038 bimë narkotike *Cannabis sativa*, ndërsa në një parcelë u gjet dhe u bllokua me cilësinë e provës materiale 19 kg e 378 gramë, bimë narkotike *Cannabis sativa*, e prerë dhe e varur për t’u tharë.

- Në datë 22.9.2016, në vendin e quajtur Ballok, në fshatin Vinjoll, Milot, në një ambient të mbuluar me plasmas, u gjetën dhe u bllokuan me cilësinë e provës materiale 69 kg, e 700 gramë, lëndë narkotike *Cannabis sativa*.

- Në datë 25.9.2016, në fshatin Vinjoll, në një zonë të pyllëzuar, u gjetën të mbjella dhe u asgjësuan 70 bimë narkotike të llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 27.9.2016, në fshatin Vinjoll, Kurbin, në malin e Trollës, u gjetën dhe u asgjësuan 3720 bimë narkotike *Cannabis sativa* gjysmë të thara dhe u sekuestrua 2406 gramë bimë e dyshuar narkotike e llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 27.9.2016, në fshatin Gallatë, në një zonë të pyllëzuar, në 3 parcela, u gjetën të mbjella dhe u asgjësuan 130 bimë të dyshuara narkotike të llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 1.10.2016, në fshatin Shpërdhet, në zonë të pyllëzuar, në 4 parcela, u gjetën të kultivuara dhe u asgjësuan 330 bimë të dyshuara narkotike të llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 30.9.2016, në fshatin Vinjoll, në vendin e quajtur Perlat, në 4 parcela, u gjetën të kultivuara dhe u asgjësuan 565 bimë të dyshuara narkotike të llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 7.10.2016, ora 20:00, në Shën Mëri, në tri ambiente të improvizuara u gjetën duke u tharë 8 kg, e 220 gramë, bimë narkotike e llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 7.10.2016, në fshatin Shën Mëri, në një parcelë u gjetën të mbjella dhe u asgjësuan 40 bimë dhe 3920 gramë lëndë bimore e tharë të llojit *Cannabis sativa*.

- Në datë 14.10.2016, në fshatin Vinjoll, Kurbin, në malin e Trollës, në një stan, u gjetën për t’u tharë 120 degë bimë narkotike *Cannabis sativa* dhe në një thes plastmase u gjetën disa boçe *Cannabis sativa* gjysëm të thara.

- Në datë 14.10.2016, në malin e Trollës, fshati Vinjoll Kurbin, në vendin e quajtur “Stani i Dashit”, në një parcelë, u konstatuan të mbjella 100 bimë narkotike *Cannabis sativa*, ndërsa rreth 1300 bimë të tjera ishin të prera e të krasitura, ndërsa të varura për t’u tharë u gjetën 18.000 bimë narkotike *Cannabis sativa*.

- Në datë 16.10.2016, në fshatin Vinjoll, në dy parcela, u gjetën të kultivuara dhe u asgjësuan 70 bimë narkotike *Cannabis sativa*.

- Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 3328 gramë lëndë narkotike *Cannabis sativa*.

- Në datë 16.10.2016, në fshatin Vinjoll, në 2 parcela, u gjetën të kultivuara dhe u asgjësuan 70 bimë narkotike *Cannabis sativa*.

2.1 Bimët narkotike të llojit *Cannabis*, të kultivuara, të konstatuara në gjendje të mbjellë në parcela ose në procesin e tharjes së tyre në zonën e Malit të Trollës, fshati Vinjoll, Kurbin, janë rezultat i organizimit në një formë të veçantë bashkëpunimi të të pandehurve të këtij gjykimi Lavdim Neziri (Nelaj), Lefter

Nelaj, Bledar Baboçi, Elton Haxhiu, Hashim Nelaj, Astrit Tafaj, Sami Balloku, Bajram Hidri, Aldo Xhaferri.

2.2 Parcelat e mbjella me bimë narkotike të llojit *Cannabis sativa* dhe ato në procesin e tharjes të gjetura në zonës e Shën Mërisë janë rezultat i bashkëpunimit të pandehurve Bashkim Kodra dhe Aldo Xhaferri, ndërsa ato të gjetura në banesën e të pandehurit Sami Balloku janë rezultat i kultivimit në bashkëpunim me tij, të pandehurit Astrit Tafaj dhe personave të tjerë të paidentifikuar.

2.3 Të dhënat e përftuara nga provat e këtij gjykimi me procedurën e një gjykimi të shkurtuar janë pasqyruar si vijon: Deklarimet e shtetasve Simon Ndoci, Zef Gjeggji, Hasan Hidri dhe të pandehurve Lefter Nelaj, Hashim Nelaj, Elton Haxhiu, Bashkim Kodra, të marra gjatë hetimeve paraprake me cilësinë e personit nën hetim ose të pandehur, akte të përfshira në fashikullin këtij gjykimi, për shkak të gjykimit të posaçëm, atij të shkurtuar të tij; procesverbalet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, shoqëruar nga tabela fotografike, që pasqyrojnë këqyrjen e vendit të ngjarjes në zonën e quajtur Trollë, në rrethinat e rrethit Mat, në vendet e quajtura “Fusha e Mizajve” dhe “Kroi i Mizajve”; prova të tjera materiale, me interes për çështjen janë gjetur po në tavolinën e improvizuar konkretisht një copëz fletë në të cilën është shënuar numri i telefonit celular 0696270114 dhe ambalazhet e paketimit të dy kartave telefonike të kompanisë “Vodafone” me nr. 0696139203 (që i përket të pandehurit Bajram Hidri) dhe tjetra (e dëmtuar) së cilës i lexohen numrat 35402..., procesverbale të transkriptimit të përgjimeve telefonike që dokumentojnë komunikimet ndërmjet të pandehurve, të lidhura këto me veprime të tjera procedurale të kryera dhe provat e përftuara ndërmjet tyre, si raportet e vëzhgimeve policore, procesverbalet e kontrollit të vendeve të ngjarjes, provat materiale (sasi e përzgjedhur e bimëve të mbjella) dhe aktet e ekspertimit biokimik të tyre nga të cilët, sipas akteve të ekspertimit, ka rezultuar bimë narkotike *Cannabis sativa*.

**3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 29, datë 16.3.2018, ka vendosur:**

1. - Deklarimin fajtor të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj) për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj) për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj) me një dënim të vetëm prej 10 (dhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 7 (shtatë) vjet burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e ekzekutimit të këtij vendimi dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

2. - Deklarimin fajtor të pandehurit Lefter Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të pandehurit Lefter Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Lefter Nelaj me një dënim të vetëm prej 10 (dhjetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

3. - Deklarimin fajtor të pandehurit Bledar Baboçi (ndryshe Noka ose Trokthi) për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të pandehurit Lefter Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Bledar Baboçi (ndryshe Noka ose Trokthi) me një dënim të vetëm prej 10 (dhjetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

4. - Deklarimin fajtor të pandehurit Elton Haxhiu për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të pandehurit Elton Haxhiu për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Elton Haxhiu me një dënim të vetëm prej 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

5. - Deklarimin fajtor të pandehurit Sami Balloku për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të pandehurit Sami Balloku për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Sami Balloku me një dënim të vetëm prej 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

6. - Deklarimin fajtor të pandehurit Hashim Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të pandehurit Hashim Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Hashim Nelaj me një dënim të vetëm prej 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

7. - Deklarimin fajtor të pandehurit Astrit Tafaj për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të pandehurit Astrit Tafaj për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Astrit Tafaj me një dënim të vetëm prej 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

8. - Deklarimin fajtor të pandehurit Aldo Xhaferri për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të pandehurit Aldo Xhaferri për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Aldo Xhaferri me një dënim të vetëm prej 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

9. - Deklarimin fajtor të pandehurit Bajram Hidri për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të pandehurit Bajram Hidri për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim. Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Bajram Hidri me një dënim të vetëm prej 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e ekzekutimit të këtij vendimi dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

10. - Deklarimin fajtor të pandehurit Bashkim Kodra për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 284/2 të KP-së dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht të të pandehurit Bashkim Kodra me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga data e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

- Në bazë të nenit 190/1 të KPP-së kjo gjykatë urdhëron:...”

3.1 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në mbështetje të vendimarrjes, ka arsyetuar: “Nga të dhënat e përftuara nga provat e këtij gjykimi vlerësuar në tërësinë e tyre si: procesverbalet e transkriptimit të përgjimeve telefonike që dokumentojnë komunikimet e realizuara, të lidhura këto me veprimet e tjera procedurale të kryera dhe provat e përftuara nëpërmjet tyre si raportet e vëzhgimeve policore, të dhënat e marra nga kompanitë telefonike, procesverbalet e kontrollit të vendeve të ngjarjes, procesverbalet e sekuestrimit të sendeve, akte e ekspertimit kimik, daktiloskopik, vlerësues, teknik të sendeve të sekuestruara, kjo gjykatë vlerëson se provohet ekzistenca e faktit kriminal, ngjarje e muajve qershor-tetor të vitit 2016, ndodhur në malin e Trollës, fshati Vinjoll, Kurbin, e cilësuar ligjërisht si vepra penale e “Kultivimit të bimëve narkotike” e parashikuar nga neni 284/1 i KP-së e kryer në një formë të veçantë bashkëpunimi, ajo e grupit të strukturuar kriminal, e parashikuar në nenin 28/4 të KP-së, mes të pandehurve të këtij procesi Lavdim Neziri (Nelaj), Lefter Nelaj, Bledar Baboçi (Trokthi), Elton Haxhiu, Sami Balloku, Hashim Nelaj, Astrit Tafaj, Aldo Xhaferri, Bajram Hidri dhe shtetasve të tjerë të paidentifikuar; dhe e veprës penale ndodhur në Shën-Mëri, Kurbin, të “Kultivimit të bimëve narkotike” e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 284/2 i KP-së për të pandehurin Bashkim Kodra. Të pandehurit e këtij procesi Lavdim Neziri (Nelaj), Lefter Nelaj, Bledar Baboçi, (Trokthi), të lindur dhe banues në Kurbin me lidhje gjaku (të pandehurit Nelaj vëllezër mes tyre dhe të pandehurit Elton Haxhiu, Bajram Hidri dhe Hashim Nelaj i kanë nipër) e lidhje vjetër shoqërore (vëllezërit Nelaj më të pandehurin Bledar), së bashku me shtetas të tjerë të paidentifikuar, rreth muajit qershor të vitit 2016, iu ka lindur mendimi kriminal më qëllim të qartë përfitimi material, për t’u organizuar në një grupim me bashkimin e kontributeve të secilit për kultivimin e bimëve narkotike të llojit cannabis. Për këtë qëllim ata kanë përfshirë në grupimin e tyre kriminal, persona të tjerë të njohur prej kohësh, me të cilët kishin gjithashtu lidhje gjaku apo shoqërore, të cilët do t’i ndihmonin në realizimin e procesit të kultivimit në terren të bimëve narkotike duke filluar që nga procesi i punimit të tokës, mbjelljes së bimëve narkotike të llojit cannabis, kujdesit për rritjen e tyre, deri në periudhën e vjeljes së tyre, tharjes dhe paketimit, të identifikuar si të pandehurit e këtij gjykimi Hashim Nelaj, Astrit Tafaj, Aldo Xhaferri e Bajram Hidri. Për realizimin e këtij plani kriminal grupimit të pandehurve u janë bashkuar dhe të pandehurit Elton Haxhiu (nip i vëllezërve Lavdim e Lefter) e Sami Balloku nëpërmjet ndihmës së dhënë prej tyre për furnizimin me ushqime dhe mjete ndihmëse në aktivitetin e kultivimit...”

3.2 Në faktin penal objekt i këtij gjykimi konstatohet se kanë bashkëpunuar një numër i madh personash, të identifikuar tërësisht vetëm nëntë të pandehurit e këtij gjykimi dhe një i gjykuar më vete. Ky bashkëpunim mes tyre nuk ka qenë i rastësishëm, por i mirorganizuar, i përgatitur të paktën disa muaj para momentit të arrestimit të tyre dhe ka vazhduar gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprave penale. Ky grupim i krijuar me qëllim të qartë përfitimi material, nisur nga të dhënat e përftuara në këtë gjykim, ka pasur një strukturë të qëndrueshme dhe një organizim që kalonjë bashkëpunimin e thjeshtë, me ndarje rolesh mes pjesëtarëve të tij... Konkretisht të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj), Lefter Nelaj, Bledar Baboçi, (Trokthi), nga të dhënat e përftuara nga provat (kryesisht përgjimet telefonike të transkriptuara) rezulton qartë se janë krijuar të grupimit kriminal (por jo të vetmit) me rol dominues mes tyre, i pandehuri Lavdim, i cili është drejtues dhe financues i aktivitetit. Rol të rëndësishëm ka dhe i pandehuri Baboçi që ka marrë përsipër menaxhimin e mjeteve monetare të aktivitetit kriminal dhe i pandehuri Lefter Nelaj, që organizon dhe drejton kultivimin e bimëve narkotike në parcelat konkrete. Gjithë të pandehurit e tjerë janë pjesëmarrës në grupimin kriminal, që prej krijimit të tij, të cilët gjykata i liston sipas rëndësisë së secilit në këtë pjesëmarrje: Elton Haxhiu, Hashim Nelaj, Astrit Tafaj,

Bajram Hidri, Aldo Xhaferri, Sami Balloku. Ajo që e dallon grupimin kriminal të të pandehurve të këtij gjykimi është lidhja e gjakut mes pjesës më të madhe të tyre dhe shoqërore disa prej tyre që ka lehtësuar bashkimin më qëllim përfitimi kriminal dhe ka forcuar lidhjet mes tyre, duke rritur rrezikshmërinë e këtij grupimi. Të pandehurit e këtij procesi në rolin që kanë me ndërgjegje dhe vullnet të plotë kanë bashkuar kontributet e tyre, si pjesë e një të tërë, në realizimin e një plani të përbashkët kriminal, si një entitet i vetëm, për të bërë reale veprën penale të kultivimit të bimëve narkotikëve të llojit cannabis për të cilën u bashkuar. Lidhur me llojin e bimës së kultivuar konfirmohet me të dhënat e akteve të ekspertimit kimik të sasive të përzgjedhura, se është Cannabis sativa. Lidhur me të pandehurin e gjykuar më vete Alban Gjergji, gjykata në këtë vendim nuk jep vlerësimin e saj pavarësisht se i është referuar bisedave të transkriptuara për shkak se kjo çështje i përket trupit tjetër gjykoës, atij që gjykon çështjen ndaj këtij të pandehuri. Komunikimet në distancë, mes bashkëpunëtorëve të këtij aktiviteti kriminal realizoheshin me numrat telefonikë përkatës: i pandehuri Lavdim Neziri (Nelaj) përdorues i numrit telefonik 0039 38 81 90 74 59 (sepse në kohën e ngjarjes ndodheshin jashtë shtetit në Itali me masë sigurimi “arrest në shtëpi”), i pandehuri Lefter Nelaj përdorues i numrave telefonikë 068 27 55 558, 068 55 99 577, 069 51 51 922, 069 62 70 114, i pandehuri Bledar Baboçi përdorues i numrave telefonikë 0695151991, 0694849464, i pandehuri Elton Haxhiu përdorues i numrit telefonik 069 46 58 943, 068 55 51 122 i pandehuri Hashim Nelaj përdorues i numrit telefonik 068 30 50 910 dhe 068 28 20 062, Astrit Tafaj përdorues i numrit telefonik 068 47 48 170, Aldo Xhaferri përdorues i numrit telefonik 069 45 75 613, i pandehuri Bajram Hidri përdorues i numrit telefonik 06962 70 084, i pandehuri Sami Balloku përdorues i numrit telefonik 068 53 82 205.

3.3 Identifikimi i të pandehurve të këtij gjykimi si përdorues të numrave telefonikë përkatës është bërë ose me anë të regjistrimit në emrin personal të tyre (i pandehuri Baboçi dhe Hidri) vetidentifikimit ose identifikimit nga bashkëbiseduesit e tyre gjatë bisedave telefonike të përgjuara dhe gjetjes në zotërim të kartave telefonike ose ambalazheve të tyre në momentin e arrestimit. Të dhëna me interes për identifikimin e numrave telefonikë të përdorur nga të pandehurit e këtij gjykimi jep dhe akti i ekspertimit teknik nr. 1499, datë 17.2.2017 të aparatit dhe kartës telefonike të pandehurit Hashim Nelaj, sekuestruar atij në momentin të arrestimit, i cili ka nr. Imei 351848075382462, gjykata e evidenton regjistrimin e numrit 068 55 51 122 me emrin Elton (i pandehuri Elton Haxhiu), numrit 068 27 55 558 me emrin Xh. Bisha, numrin 068 55 99 577 me emrin Tufi, (numra telefonikë të përdorur nga xhaxhai i tij, i pandehuri Lefter Nelaj), numrin 068 44 15 184 me emrin Albani (i pandehuri i gjykuar më vete Alban Gjergji), numrin 068 47 48 170 me emrin Astriti 2 (i pandehuri Astrit Tafaj), me numrin 069 51 51 991 me emrin Bledi (i pandehuri Bledar), me numrin 068 2820 062 me emrin Lani (i pandehuri Bajram Hidri). Lidhur me alibinë e ngritur nga mbrojtja dhe i pandehuri Elton Haxhiu se numri telefonik 068 55 51 122, i është marrë atij nga daja, i pandehuri Lefter Nelaj që prej datës 15.6.2016 dhe nuk është përdorur më nga i pandehuri Haxhiu, i cili ka qenë edhe jashtë shtetit në këtë periudhë, kjo gjykatë konkludon se është e pavërtetë dhe bie në kundërshtim me të dhënat e përfshuara nga provat e këtij gjykimi. Fakti se i pandehuri Haxhiu është larguar jashtë shtetit në kohën e kryerjes së veprës penale dhe interceptimet telefonikë të tij, konfirmohen me të dhënat e sistemit TIMS, por këto dalje janë dyditore (1.7.2016 dhe 4.8.2016), madje në njërin prej datave (1.7.2016) ka hyrje dhe dalje në të njëjtën ditë dhe gjatë komunikimeve me interes për hetimin (në kohën që ka qenë në territorin shqiptar) ai jep personalisht të dhëna identifikuese, që rrëzojnë alibinë e tij dhe të mbrojtjes. Në datën 1.8.2016, ora 10:28 fillojnë të dokumentohen nga Prokuroria për Krime të Rënda komunikimet implikuese në veprën penale mes autorëve të ngjarjes penale, që duket në përmbajtjen e bisedës së zhvilluar mes përdoruesit të numrit telefonik 068 27 55 558 (i pandehuri Lefter Nelaj) dhe 068 47 48 170 (i pandehuri Astrit (Titi) Tafaj), bisedë nga e cila gjykata merr informacionin se bimët narkotike ishin në fazë të rritur të tyre pasi të pandehurit Astrit dhe personave të tjerë që punonin me të (i pandehuri Lefter e pyet në numrin shumë a u lodhët?) u dëshpëruan disa (rreçe për me lidh) rripa për t'i lidhur (mbajtur drejtimin e bimëve) dhe ia kërkon ato të pandehurit Lefter që merrej me organizimin e punëve.

3.4 I pandehuri Lefter Nelaj është pjesëtar i grupit kriminal që mban komunikime me punonjësit e policisë në zonën e Kurbinut (hetuar në një procedim më vete), rol që duket qartë në përmbajtjen e bisedës së datës 1.8.2016, ora 07:33 ku nëpërmjet numrit telefonik (+558) komunikon me përdoruesin e numrit (+490 i paidentifikuar) i cili e njofton se i kanë prishur parcelën e mbjellë me lëndë narkotike. I pandehuri Lavdim Neziri (Nelaj) ka rol dominues në grupimin kriminal të pandehurve të këtij procesi dhe drejton e financon aktivitetin kriminal edhe pse jo i pranishëm fizikisht në Shqipëri. Ky fakt del i qartë nga përmbajtja e bisedës telefonike të datës 1.8.2016 ora 21:19 zhvilluar mes të pandehurve Lavdim Neziri (Nelaj) e Lefter Nelaj (vëllezër mes tyre) identifikuar me emrin Ladi. (...) Nga përmbajtja e kësaj bisede kjo gjykatë përfton informacionin e rëndësishëm se bashkëpunimi mes të pandehurve të këtij procesi nuk ka qenë rastësor, por me kohë të gjatë përgatitje të mëparshme dhe me veprime të përsëritura kriminale në fushën e kultivimit të narkotikëve (të llojit bimor Cannabis sativa), me financimin e personave të tjerë të paidentifikuar, përveç të pandehurit Neziri, lidhje shoqërore e të

pandehurit Lavdim. Po nga përmbajtja e kësaj bisede dalin të dhëna të rëndësishme për të pandehurit Lefter Nelaj, Bledi (Bledar Baboçi), Eltoni (Elton Haxhiu), Ashimi (Hashim Nelaj) të cilët të gjithë shkonin në tokat e mbjella me lëndë narkotike që ndodheshin në Vinjoll, por në mal (tërma-terposht në gjuhën letrare lart-poshtë). Këtë të dhënë të përfshirë nga biseda e përgjuar, kjo gjykatë e vlerëson në lidhje me procesverbalet e këqyrjes së vendit të ngjarjes të datës 21.9.2016, sipas të cilit në vendin e quajtur Trollë, fusha e Mizajve, Mat, në 2 parcela u gjetën të mbjella dhe u asgjësuan 1038 bimë narkotike Cannabis sativa, ndërsa në një parcelë u gjet dhe u bllokua me cilësinë e provës materiale 19 kg e 378 gramë, bimë narkotike Cannabis sativa e prerë dhe e varur për t'u tharë. Vetë i pandehuri Lefter Nelaj pohoi nëpërmjet deklaramit se ka kultivuar bimë narkotike në parcelën që ndodhet në fushën e Mizajve edhe pse pranoi vetëm një sasi të reduktuar të saj (170 bimë). Në komunikimin e datës 2.8.2016, ora 13:59 të zhvilluar mes të pandehurit Lefter Nelaj (+558) dhe përdoruesit të numrit +317 i identifikuar vetëm si Miri, gjykata përfton informacionin se personat e angazhuar me veprime konkrete në parcelat me bimë narkotike, i identifikuar në këtë bisedë, i pandehuri Astrit qëndrojnë atje (i referohen si stani jonë) dhe i pandehuri Lefter organizon punët për t'u krijuar kushte të përshtatshme qëndrimi (duke iu siguruar gjenerator, dërguar ushqime, veshje etj.), madje qëndron dhe punon së bashku me ta. Edhe këtë të dhënë kjo gjykatë e vlerëson të lidhur me procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes së datës 14.10.2016, ku në malin e Trollës, fshati Vinjoll Kurbin, në vendin e quajtur "Stani i Dashit", në një parcelë janë konstatuar të mbjella 100 bimë narkotike Cannabis sativa ndërsa rreth 1300 bimë të tjera ishin të prera e të krasitura. Të varura për t'u tharë u gjetën 18.000 bimë narkotike Cannabis sativa. Rolin organizues të veprimtarisë së kultivimit i pandehuri Lefter Nelaj e ka marrë përsipër së bashku me të pandehurin Bledar Baboçi, përdorues i numrit telefonik 069 51 51 991 (regjistruar në emrin e tij personal), fakt që del i qartë në bisedën e zhvilluar mes tyre në datën 2.8.2016, ora 14:41 ku bisedojnë mes tyre për gjetjen e disa veglave bujqësore (capi). Të pandehurit e këtij procesi kanë përzgjedhur për të mbjellë me bimë narkotike zona larg qendrave të banuara dhe përveç bashkëpunimit me punonjës të policisë për të ruajtur të paprekura ato, kujdesen edhe vetë duke mbajtur në kontroll lëvizjet e çdo personi që për ta është i dyshimtë dhe përbën rrezik për zbulimin e veprimtarisë së tyre. Në bisedën e datës 7.8.2016 ora 13:21, zhvillohet një komunikim telefonik mes të pandehurve Bledar Baboçi (+991) dhe Hashim Nelaj (+910), bisedë nëpërmjet së cilës i pandehuri Hashim vetidentifikohet si përdorues i numrit (+910). Nga përmbajtja e këtij komunikimi gjykata përfton të dhënat se personi më i besuar i të pandehurit Lavdim Nezirri, të cilit i ka lënë detyrën e menaxhimit të shpenzimeve në funksion të aktivitetit kriminal është i pandehuri Bledar Baboçi, të cilin i pandehuri Hashim e pyet edhe për sasinë e furnizimit me karburant të automjetit (me të cilin lëviznin nga qendra e banuar për në zonat ku ishin mbjellë lëndë narkotike). Po në këtë bisedë përfshihet informacioni se i pandehuri Hashim është duke shkuar për te parcelat e bimëve narkotike ku do të shkonte në ditët në vijim edhe i pandehuri Baboçi dhe i pandehuri Elton. Nga përmbajtja e kësaj bisede gjykata përfton informacionin se i pandehuri Bashkim Kodra ka punësuar për kultivimin e narkotikëve të pandehurin Aldo dhe ky proces ndodhet në fazën e mbledhjes së produktit të korrur i cili duhet të vazhdojë me procesin e tharjes, që përputhet me gjendjen e faktit (dy ditë më pas) në procesverbalin e këqyrjes së datës 7.10.2016, në Shën Mëri, Kurbin ku janë gjetur në tri ambiente të improvizuara duke u tharë 8 kg e 220 gramë bimë narkotike të llojit Cannabis. Në vazhdim, i pandehuri Aldo është lajmëruar se do shkojnë për ta shoqëruar dhe se e ka numrin telefonik në përgjim, fakt për të cilin njofton dhe të pandehurin Lefter Nelaj në bisedat të datës 6 dhe 7.10.2016.

3.5 Lidhur me të pandehurin Bashkim Kodra nga të dhënat e përfshira nga provat e këtij gjykimi, vlerësuar në tërësinë e tyre si të dhënat e transkriptimeve të përgjime telefonike, të dhënat e përfshira nga këqyrja dhe ekspertimi teknik i telefonit, lidhur këto me procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe provat materiale të sekuestruara provohet fakti se me veprimet e tij të kryera në bashkëpunim më të pandehurin Aldo Xhaferri ka konsumuar elementet e veprës penale të "Kultivimit të bimëve narkotike", në formën e bashkëpunimit të thjeshtë, parashikuar nga neni 284/2 i KP-së. Veprimet penalisht të dënueshme të pandehurit Kodra edhe pse janë në fushën e kultivimit të bimëve narkotike të llojit cannabis me qëllim përfitimi, nuk kanë lidhje dhe ndërveprime me bashkëpunimin e veçantë të grupit të strukturuar kriminal të pandehurve të këtij procesi me drejtues të pandehurin Nezirri, por ajo që provohet është vetëm bashkëpunimi i tij me të pandehurin Aldo Xhaferri duke konsumuar elementet e veprës penale atë të "Kultivimit të bimëve narkotike", në formën e bashkëpunimit të thjeshtë, parashikuar nga neni 284/2 i KP-së. Veprimet penalisht të dënueshme të pandehurve Sami Balloku, Astrit Tafaj dhe Aldo Xhaferri edhe pse kanë brenda tyre kultivimin e bimëve narkotikëve në një formë bashkëpunimi të thjeshtë mes tyre në kushtet kur provohet organizimi i tyre në të njëjtën veprimtari kriminale kultivimi, në formë të veçantë bashkëpunimi ata do të përgjigjen penalisht për këtë të fundit e cila, duke qenë më e rëndë, përfshin brenda saj edhe bashkëpunimin e thjeshtë të konsumuar me veprimet e tyre."

4. Kundër vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka paraqitur apel i pandehuri Bledar Baboçi, i cili ka kërkuar: "Ndryshimin e vendimit dhe deklaramin e

*pafajshëm të tij për veprat penale “Kultivim të bimëve narkotike”, “Krijimit të grupit të strukturuar kriminal”, “Kryerjes së veprave penale nga organizata kriminale dhe grupit të strukturuar kriminal”, të parashikuar nga nenet 284/1, 28, 333/a/a, 334/1 të KP-së. Lirimin e menjëhershëm të pandehurit Bledar Baboçi nga ambiente e paraburgimit nëse nuk mbahet për ndonjë veprë penale tjetër në ngarkim të tij”.*

**5. Kundër vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kanë paraqitur apel të pandehurit Astrit Tafaj dhe Aldo Xhaferri, të cilët kanë kërkuar: “Ndryshimin e vendimit objekt ankimi dhe deklarimin e pafajshëm lidhur me akuzën, heqjen e masës së sigurimit dhe lirimin e menjëhershëm”.**

**6. Kundër vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kanë paraqitur apel të pandehurit Lefter Nelaj, Lavdim Neziri (Nelaj), Sami Balloku, Halim Nelaj, Bajram Hidri dhe Elton Haxhiaj, të cilët kanë kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për të pandehurit Lefter Nelaj, Lavdim Neziri (Nelaj), Sami Balloku, Halim Nelaj, Bajram Hidri dhe Elton Haxhiaj, në këtë mënyrë:**

*- Pushimin e çështjes penale për akuzat e grupit të strukturuar kriminal dhe të kryerjes së veprës penale nga anëtarë i grupit të strukturuar kriminal të parashikuar nga nenet 333/a e 334/1 të KP-së për të gjithë të pandehurit e lartpërmendur pasi ato vepra nuk janë kryer e nuk ekzistojnë. Pushimin e çështjes penale për akuzën e kultivimit të bimëve narkotike në ngarkim të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj) pasi nuk e ka kryer atë veprë.*

*- Pushimin e çështjes penale për akuzën e kultivimit të bimëve narkotike në ngarkim të pandehurit Elton Haxhiu pasi nuk provohet ta ketë kryer atë.*

*- Deklarimin fajtor të pandehurve Hashim Nelaj dhe Bajram Hidri për veprën penale të moskallëzimit të krimit sipas nenit 300 të KP-së dhe dënimit e tyre. Hashim Nelaj me kohën e paraburgimit, Bajram Hidri me një dënim sa më të butë duke marr parasysh moshën e tij të re, nivelin e ulët arsimor, qenien e tij i padënuar më parë dhe faktin se është tërhequr në krim nga daja i tij, i pandehuri Lefter Nelaj.*

*- Deklarimin fajtor të pandehurit Lefter Nelaj për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike parashikuar në neni 284/1 të KP-së dhe dënimit e tij me një dënim sa më të butë duke mbajtur parasysh faktin se është kryefamiljar me 3 fëmijë të mitur në ngarkim, bashkëshortja e papunë dhe pa asnjë të ardhur ekonomike.*

*- Deklarimin fajtor të pandehurit Sami Balloku për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike të parashikuara nga neni 284/1 i KP-së dhe dënimit e tij me një dënim sa më të butë duke u mbajtur parasysh dhe faktin se është i sëmurë me tuberkuloz (TBC), kryefamiljar me 3 fëmijë të mitur e gjendje ekonomike të rënduar.*

**7. Kundër vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka paraqitur ankim i pandehuri Bashkim Kodra, i cili ka kërkuar: “Ndryshimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me anën e të cilit është vendosur “Deklarimi fajtor i të pandehurit Bashkim Kodra, për kryerjen e veprës penale të “Kultivim i bimëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i KP-së dhe dënimit e tij me një dënim sa më të butë duke mbajtur parasysh faktin se është kryefamiljar me 3 fëmijë të mitur në ngarkim, bashkëshortja e papunë dhe pa asnjë të ardhur ekonomike. Deklarimin e pafajshëm të pandehurit Bashkim Kodra, akuzuar për veprën penale “Kultivim i bimëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i KP-së, si të pabazuar përtej çdo dyshimi në prova dhe në ligj. Urdhërimin e lirit të menjëhershëm të tij nga dhomat e paraburgimit, nëse nuk ndiqet për ndonjë veprë tjetër penale”.**

**8. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, me vendimin nr. 60, datë 12.6.2018, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë si më poshtë:**

*- Deklarimin fajtor të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj) për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal të parashikuar nga nenet 28/4 dhe 284/1 të KP-së e në bazë dhe të nenit 334/1 të KP-së e dënimit e tij me 9 (nëntë) vjet burgim.*

*- Pushimin e akuzës për të pandehurin Lavdim (Neziri) Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal” të parashikuar nga neni 333/a/1 të KP-së.*

*- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimit e të pandehurit Lavdim (Neziri) Nelaj me 6 (gjashtë) vjet burgim.*

*- Deklarimin fajtor të pandehurit Lefter Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 28/4 e 284/1 të KP-së e në lidhje me nenin 334/1 të KP-së dënimit e tij me 9 (nëntë) vjet burgim.*

- Pushimin e akuzës për të pandehurin Lefter Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a/1 të KP-së.
- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimin e të pandehurit Lefter Nelaj me 6 (gjashtë) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Bledar Baboçi (Noka ose Trokthi) për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 284/2 të KP-së dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.
- Deklarimin e pafajshëm të pandehurit Bledar Baboçi (Noka ose Trokthi) për veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal” si dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” parashikuar nga nenet 333/a/1 e 334/1 të KP-së, pasi nuk provohet të ketë kryer veprën penale.
- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimin e të pandehurit Bledar Baboçi (Noka ose Trokthi) me 4 (katër) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Elton Haxhiu për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal të parashikuar nga nenet 28/4 e 284/1 të KP-së, si dhe në lidhje dhe me nenin 334/1 të KP-së dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.
- Pushimin e akuzës për të pandehurin Elton Haxhiu për veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal” të parashikuar nga neni 333/a/2 të KP-së.
- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimin e tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Sami Balloku për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuara nga nenet 28/4 e 284/1 si dhe në lidhje dhe me nenin 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.
- Pushimin e akuzës për të pandehurin Sami Balloku për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a/2 të KP-së.
- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimin e të pandehurit Sami Balloku me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Hashim Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 284/2 të KP-së, e në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.
- Deklarimin e pafajshëm të pandehurit Hashim Nelaj për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” të parashikuara nga nenet 333/a-2 e 334 të KP-së, pasi nuk provohet kryerja e veprës penale.
- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimin e të pandehurit Hashim Nelaj me 4 (katër) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Astrit Tafaj për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 28/4 e 284/1 të KP-së, dhe në lidhje dhe me nenin 334/1 të KP-së dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.
- Pushimin e akuzës për të pandehurin Astrit Tafaj për kryerjen e veprës penale për “Grupin e strukturuar kriminal” të parashikuar nga neni 333/a/1 të KP-së.
- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimtar të të pandehurit Astrit Tafaj me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Aldo Xhaferri për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 28/4 e 284/1 si dhe në lidhje dhe me nenin 334/1 të KP-së e dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.
- Pushimin e akuzës për të pandehurin Aldo Xhaferri për kryerjen e veprës penale të “Grupit të strukturuar kriminal” të parashikuar nga neni 333/a/2 të KP-së.
- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimin përfundimisht me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit Bajram Hidri për kryerjen e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 284/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.
- Deklarimin e pafajshëm të pandehurit Bajram Hidri për veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal” si dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” të parashikuara nga nenet 333/a/2 e 334/1 të KP-së, pasi nuk provohet.

- Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së dënimin e të pandehurit Bajram Hidri me 4 (katër) vjet burgim.  
- Lënien në fuqi të vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë për pjesët e tjera të tij”.

8.1 Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në mbështetje të vendimmarrjes, ka arsyetuar: “Vendimi nr. 29 datë 16.3.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është i drejtë i bazuar në prova dhe në ligj, sa u përket disponimeve për të gjithë të pandehurit për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale të parashikuar nga neni 284 i KP-së ashtu edhe për masat e dënimit respektive të caktuara dhe si i tillë në bazë të nenit 428/1 shkronja “a” të KPP-së duhet lënë në fuqi, duke u ndryshuar vendimi sa u përket të pandehurve Lavdim Nelaj, Lefter Nelaj, Elton Haxhiu, Sami Balloku, Astrit Tafaj, Aldo Xhaferri e Bajram Hidri lidhur me akuzën për kryerje të veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal” të parashikuar nga neni 333/a/1 të KP-së duke u pushuar kjo akuzë. Për të pandehurit Bledar Baboçi, Hashim Nelaj e Bajram Hidri në referim të nenit 388 të KPP-së ndryshohet ky vendim duke u deklaruar të pafajshëm për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, si dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” të parashikuara nga nenet 333/a/2 e 334/1 të KP-së, pasi nuk provohet. Lidhur me të pandehurin Bashkim Kodra, ky koleg në mënyrë të njëjtë si në konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë, çmon se në bashkëpunim me të pandehurin Aldo Xhaferri ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 284/2 i KP-së në formën e bashkëpunimit të thjeshtë, veprimet e tij nuk kanë lidhje dhe ndërveprim e bashkëpunim të veçantë të grupit të strukturuar kriminal të të pandehurve të këtij procesi me drejtues të pandehurin Nezirri. Ky koleg si dhe gjykata e shkallës së parë e gjen të provuar faktin penal të gjetjes dhe sekuestrimit të bimëve narkotike...

8.2 Sikundër nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, i konfirmuar nga ky koleg, fakti i ndodhjes së ngjarjeve që ka të bëjë me kultivimin e bimëve narkotike, kryer në bashkëpunim është provuar dhe verifikuar në gjykim me provat shkresore të pasqyruara në vendimin e ankimuar. Të dhënat e përfuara nga provat e këtij gjykimi mbi procedurën e gjykimit të shkurtuar janë pasqyruar në aktet e administruara në dosje. Në interpretim të nenit 28/4 dhe 333/a të KPP-së, të cilat kanë dalë në bazë dhe për zbatim të detyrimeve që janë marrë përsipër nga shteti shqiptar me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokollet shtesë, gjykata çmon se veprimet e të pandehurve plotësojnë kushtet ligjore të parashikuar nga këto nene që bashkëpunimi i tyre të konsiderohet në formën e grupit të strukturuar kriminal. Sipas dispozitave të përmendura më lart (dhe dispozitave të konventës) që të jemi para bashkëpunimit në formën e grupit të strukturuar kriminal duhet: - të jetë një formë e veçantë bashkëpunimi që të plotësohet kriteri numerik i pjesëmarrësve ku duhet të jenë tre ose më shumë persona; - këta persona kanë bashkëpunuar për kryerjen e një ose më shumë veprave penale; - kjo vepër penale kryhet për të realizuar përfitime materiale ose jomateriale; - ky bashkëpunim për formimin e grupit të strukturuar kriminal për kryerjen e veprës (ose veprave penale) nuk formohet rastësisht, pra ka një shtrirje të caktuar kohore; - grupi i strukturuar kriminal nuk kërkohet të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash apo strukturim të zhvilluar, por një strukturë dhe organizim sado minimal duhet ta ketë;. Për sa u përket elementeve të bashkëpunimit pavarësisht se në rastin konkret jemi në formën e bashkëpunimit të veçantë, gjykata çmon se vlejné dhe mban parasysh unifikimin e praktikës gjyqësore me vendimin unifikues penal nr. 4/2011, KB të Gjykatës së Lartë, i cili thekson se “që të ndodhemi në kushtet e bashkëpunimit duhet të bashkëekzistojnë si kushte sine qua non: 1. dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash); 2. realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementët e tij materialë; 3. dhënia e një kontributi relevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve; ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal”. Gjithashtu, në vendimin në fjalë unifikohet praktika se kur nga pikepamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paafësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë. Siç është theksuar edhe më sipër (për më tepër referuar provave shkresore, deklaramëve të të pandehurve, cituar më sipër) i pandehuri Nelaj, pasi e krijoi grupin kriminal, ndër to për të realizuar kultivimin e bimëve narkotike, veprimtari e mirorganizuar, me qëllim përfitimi. Pra elementi numerik që kërkon dispozita në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal në rastin konkret në gjykim plotësohet.

8.3 Për sa i përket elementit tjetër që është përfitimi material ose jomaterial, gjatë gjykimit u provua që kultivimi i bimëve narkotike ishte përfitimi material. (për më tepër referohu te rrethanat e faktit). Për sa i përket elementit tjetër të grupit të strukturuar kriminal, që është shtrirja në kohë (pra të mos jetë formuar rastësisht), nga provat që ndodhen në dosje rezultojnë se ky aktivitet kriminal ka zgjatur të paktën që nga muaji gusht deri në tetor, kur edhe janë arrestuar disa nga

të pandehurit. Pra, elementi kohor nuk është i pakët duke pasur parasysh se gjatë kësaj periudhe janë kryer këto vepra penale në lidhje me lëndët narkotike. Për sa i përket elementit tjetër të grupit të strukturuar kriminal që është bashkëpunim për kryerjen e një ose më shumë veprave penale, gjykata çmon se edhe ky element ligjor plotësohet në rastin konkret në gjykim. Gjatë gjykimit u provua se gjatë kohëvazhdimit të këtij grupi të strukturuar kriminal është kryer vepra e kultivimit të bimëve narkotike. Në dispozitat e cituara më lart, përcaktohet se grupi i strukturuar kriminal nuk dallohet për një organizim dhe strukturim të zhvilluar, por nënkuptohet se grupi i strukturuar kriminal ka një farë strukture apo organizim sado minimal qoftë.

8.4 Gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi e provuar se krijuesit, drejtuesit dhe organizuesit e këtij grupi të strukturuar kriminal ishin të pandehurit Nelaj etj., (faktet, rrethanat dhe provat janë cituar më lart), ndërsa të pandehurit e tjerë, pavarësisht se janë në bashkëpunim, ky lloj bashkëpunimi i tyre rezultoi i “thjeshtë”, nisur nga marrëveshja e tyre, episodi në të cilin marrin pjesë si dhe veprimet konkrete që ata kryejnë. Ky kolegji vlerëson se, bashkëpunimi i të pandehurve të tjerë që janë, i pandehuri Bledar Baboçi, Hidri e Hashim Nelaj, nuk është i atij niveli që të konsiderohet si i kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, pasi: Së pari, duke iu referuar akteve dhe provave të paraqitura nga organi i akuzës dhe të administruara nga ana e gjykatës, nuk provohet që ndodhemi përpara veprës penale të “Grupi i strukturuar kriminal” si formë e veçantë e bashkëpunimit, pasi mbështetet vetëm në përgjimet telefonike në të cilat për asnjë moment nuk konstatohet që i mbrojturi Baboçi apo dhe bashkëbiseduesi i tij të përdorin fjalë apo të flasin për “kultivim të bimëve narkotike” apo “bime narkotike” dhe për këtë arsye gjykata nuk mund të vlerësojë si provë për sa kohë këto përgjime nuk shoqërohen me prova të tjera konkrete që të konfirmojnë vërtetësinë e tyre, por, duhet të vlerësohen vetëm si indicie për sa kohë nuk ka asnjë akt apo provë tjetër që të konfirmojë këtë indicie dhe të tregojë se ajo është e vërtetë dhe e saktë. Së dyti, kjo dispozitë është e përcaktuar në nenin 28/4 të KP-së, si dhe në nenin 2 pika c të ligjit nr. 8920 datë 11.7.2002 “Për Ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”. Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përcaktohet se “që të ndodhemi përpara kësaj forme të bashkëpunimit, “Grupi i strukturuar kriminal”, duhet të ekzistojnë disa elemente juridike përcaktues. Më konkretisht: Grupi i strukturuar kriminal formohet nga bashkëpunimi i të paktën tre ose më shumë personave, bashkëpunim i cili bëhet me qëllim kryerjen e një ose disa veprave penale; gjithashtu, kërkohet që të ekzistojë bashkëpunimi për kryerjen e një ose disa veprave penale, të paktën ndërmjet tre personave, në rast të kundërt, nëse, bashkëpunimi ekziston vetëm ndërmjet dy personave, nuk mund të jemi para grupit të strukturuar kriminal, por para formave të tjera të bashkëpunimit.

8.5 Nga aktet e administruara në gjykimin në shkallë të parë, nuk u provua as se i pandehuri Baboçi ka pasur një bashkëpunim të tillë për realizimin e veprës penale në mënyrë që të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm që, ai të jetë pjesë e “grupit të strukturuar kriminal” pasi ai nuk shpreh për asnjë moment interes apo të tregojë se ka dijeni për veprimtarinë kriminale të personave të tjerë nën hetim. Grupi i strukturuar kriminal me qëllim kryerjen e një ose më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale, ka gjithmonë një nivel minimal organizimi edhe strukturimi. Në çështjen objekt gjykimi, rolin si “organizator” të pretenduar nga akuzat dhe të pranuar nga gjykata e shkallës së parë se, e ka pasur i pandehuri Bledar Baboçi, është i pambështetur në prova dhe fakte konkrete. Në këto kushte, ky kolegji vlerëson se, dyshimi i akuzës shkon në favor të të pandehurit, siç parashikon neni 4 i KPP-së. Pasi dijeni, d.m.th. të qenët të ndërgjegjshëm dhe të vullnetshëm për të marrë pjesë në realizimin e marrëveshjes dhe për pasojë në realizimin e planit kriminal, është një element kyç me anë të së cilës përcaktohet dhe roli që i është caktuar atij në raport me pjesëtarët e tjerë të grupit. Gjithashtu, nga grupi i strukturuar kërkohet dhe një qëndrueshmëri të grupit që kanë arritur marrëveshjen për realizimin e veprës penale. Parimisht, për të qenë para kësaj forme të bashkëpunimit të veçantë, kërkohet që ky bashkëpunim të ketë ekzistuar, paraprakisht, që para se të fillojë kryerja e veprës penale, dhe ky bashkëpunim të ekzistojë edhe në momentin e fillimit të kryerjes së veprës penale. Bashkëpunimi i anëtarëve të grupit të strukturuar duhet të jetë i planifikuar dhe i paramenduar, që para se të fillojë kryerja e veprës penale, në këtë gjykim nuk është arritur të provohet se i pandehuri Baboçi ka pasur dijeni për kultivimin e lëndëve narkotike, brenda një organizimi të moderuar në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe aq më tepër për destinacionin e saj, në këto kushte nuk është përgjegjës për veprat penale të kryera nga grupi i strukturuar. Gjatë gjykimit rezultoi se i pandehuri Baboçi pavarësisht se kishte rënë në marrëveshje me të pandehurin Nelaj, që ai të jepte ndihmesën e tij, këtë ndihmesë t’ia jepte të pandehurit në kultivimin e bimëve narkotike, marrëveshja dhe kontributi i tij në rastin konkret është ajo e bashkëpunimit të thjeshtë, parashikuar nga neni 25 i KP-së. Nisur nga marrëveshja dhe veprimet konkrete që ka kryer i pandehuri Baboçi gjykata arrin në përfundimin se bashkëpunimi i tij nuk është në formën e veçantë sipas nenit 28/4, 333/a të KP-së, duke qenë në rolin e ndihmësit në realizimin e kësaj vepre penale. I njëjti argument vlen dhe për të pandehurit Hashim Nelaj e Bajram Hidri (veprimet e të cilëve janë sqaruar në rrethanat e faktit të pranuar), pavarësisht se të pandehurit e tjerë Lefter Nelaj, Lavdërim Neziri

(Nelaj), Sami Balloku e kryejnë këtë vepër penale në kuadër të grupit, të pandehurit Nelaj dhe Hidri nga pjesëmarrja në episod (kohëzgjatja e këtij bashkëpunimi etj.), çmohet se bashkëpunimi është i thjeshtë, sipas nenit 25 të KP-së.

8.6 Për sa i përket përgjegjësisë për kryerjen e veprës penale në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal, në nenin 28/5/6 të KP-së parashikohet: 1. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta. 2. Anëtarët e organizatës kriminale e organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për gjitha veprat penale të kryera prej tyre në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale. Këto dispozita janë formalizuar në nenet përkatëse nenin 333/a dhe 334 të KP-së (përmbajtja e të cilave është cituar më sipër dhe nuk po biem në përsëritje). Sipas këtyre dispozitave, krijuesi përgjigjet për vetëkrijimin dhe ose anëtarësimin në grup të strukturuar kriminal, kur kjo vepër është e parashikuar si vepër penale më vete (krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal, pjesëmarrja në grup strukturuar kriminal sipas nenit 333/a/1/2), si dhe për ato vepra të kryera nga ana e grupit të strukturuar kriminal në kryerjen e së cilës personalisht i pandehuri ka marrë pjesë (kryerja sipas dispozitës së veçantë nenit 28/4, dhe 334/1 të KP-së, konkretisht të pandehurit Lavdim Neziri Nelaj) Lefter Nelaj, Elton Haxhin, Sami Balloku, Astrit Tafaj, Aldo Xhaferri). Pra, çdo anëtar i grupit të strukturuar kriminal, që më parë është dakord me aktivitetin e tij të përgjithshëm, përgjigjet për të gjitha veprat e kryera nga ana e grupit i strukturuar kriminal. Të pandehurit, duke qenë se i kanë kryer veprat penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, do të përgjigjen penalisht edhe për veprën penale të “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334/1/2 i KP-së. Të pandehurit do të përgjigjen për këtë vepër penale, sepse me veprimet e tyre të kundërligjshme, në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal, kanë kryer veprat penale të 284/1 dhe 334/1/2 të KP-së.

8.7 Gjykata bazuar në nenin 375 të KPP-së, ku theksohet se me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, më të lehtë ose më të rëndë, duke qenë në kushtet që fakti për disa episode i jepet një cilësim më i lehtë, gjykata çmon se për veprën penale të “Kultivimi i bimëve narkotike” në kuadër të grupit të strukturuar kriminal do të dënohen sipas nenit 284, 28/4 dhe nenit 334 paragrafi i parë i KP-së dhe jo sipas paragrafit të dytë të nenit 334. Kjo pasi dispozita përkatëse nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm që të jemi në parashikimet e nenit 334 paragrafi i dytë, por jemi në parashikimet e paragrafit të parë të kësaj dispozite ku dënimet për veprën konkrete i shtohen 5 (pesë) vjet. Duke qenë se nuk rëndoj, por lehtësohet pozita e të pandehurve, gjykata nuk procedoi me paragrafin e dytë të nenit 375 të KPP-së (i ndryshuar me ligjin 35/2017). Gjithashtu, ky kolegji vlerëson se në rastin në gjykim nuk u arrit të provohet që të ketë ekzistuar një organizim dhe strukturim i caktuar dhe ndarje e roleve të krijuesit shtytësit dhe ekzekutorit në këtë grup, ekzistenca e një strukture dhe një organizimi për kryerjen e veprës penale të grupi i strukturuar kriminal është një nga elementet kryesore që e dallon këtë formë bashkëpunimi të veçantë nga bashkëpunimi i thjeshtë. Nga gjykimi nuk u arrit të provohet ekzistenca e bashkëpunimit paraprak ndërmjet të paktën tre të pandehurve në kryerjen e veprës penale, të pandehurit kanë vepruar të ndarë nga njëri tjetri dhe secili për llogari të tij pa pasur një bashkëpunim të mëparshëm. Gjykata në analizë të elementeve të veprave penale për të cilat akuzohen të pandehurit çmon se dubet pranuar fakti se provat shpresore të mësipërme, nuk japin të dhëna të drejtpërdrejta mbi veprimet ose mosveprimet konkrete të secilit të pandehur, por në raport me provat e tjera të këtij procesi kanë shërbyer për të konkluduar në lidhje me ekzistencën e fajësisë apo jo të secilit të pandehur, si dhe rolin që ka pasur çdokush prej tyre në kryerjen e veprës penale, prova të cilat u analizuan në këtë gjykim.

8.8 Në lidhje me zgjidhjen në themel të kësaj çështjeje penale, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda çmon se, nuk rezulton plotësisht e provuar nga tërësia e provave të marra e të shqyrtuara në këtë gjykim fajësia e të pandehurve, siç është paraqitur nga akuzat, e pranuar si e tillë nga Gjykata për Krime të Rënda. Duke qëndruar në të njëjtën linjë arsyetimi si dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimarrjen e saj nr. 38, datë 11.5.2015, ky kolegji vlerëson se në rastin e akuzave që kanë të bëjnë me bashkëpunimin, është i rëndësishëm betimi dhe vërtetimi i elementeve strukturorë (objektivë) të veprës penale, dhe i atyre organizativë të marrëveshjes kriminale lidhur me veprën e “kultivimit të bimëve narkotike”, në bashkëpunim. Që një grup personash të jetë në gjendje të kryejë veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” në bashkëpunim, dubet që grupi të krijohet, por edhe sapo të krijohet të dalë nga faza fillestare e krijimit të tij duke ndarë detyrat dhe rolet me qëllim arritjen dhe pasjen e kapaciteteve, për kryerjen e planit kriminal të parashikuar. Për të arritur në gjendje aftësie kërkohet një farë kohe e caktuar për të krijuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë dhe gjatë kësaj kohe parapërgatitore. Pra, në momentin kur grupi që ka arritur marrëveshjen do të bëhet i qëndrueshëm dhe marrëveshja e qëndrueshme, nëpërmjet krijimit të strukturës që do të jetë mjeti për realizimin e planit kriminal, ngritja e kontakteve, krijimi i rrjetit etj. Nga ana subjektive kjo do të thotë pasje dijeni, d.m.th. të qenët i ndërgjegjshëm dhe i vullnetshëm për të

*marrë pjesë në realizimin e marrëveshjes dhe për pasojë të planit kriminal në mënyrë të përhershme e të qëndrueshme. Ky kolegji i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, çmon se, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk e ka kryer një hetim të tillë të plotë e të gjithanshëm nëpërmjet analizës e arsyetimit të tij, në respektim të parashikimeve të nenit 284, 25, 333/a dhe 334 të KP-së, dhe për pasojë të nenit 47 të KP-së, vlerësim i cili bëhet nëpërmjet analizës së shkaqeve të ankimit të paraqitura para kësaj gjykate, një pjesë e të cilave gjenden të bazuara nga kjo gjykatë.*

8.9 Në analizë e verifikim të provave në tërësi, gjykata e apelit çmon se nuk ka vend për pranimin e apeleve të mbrojtjes të cilat ky kolegji në përputhje me arsyetimin e gjykatës në vijim do të argumentojë. Kolegji i gjykatës së apelit, nisur nga pretendimet e parashtruara nga subjektet procedurale në këtë proces, vlerëson se duhet të trajtojë në mënyrë të përmbledhur faktet penale që kanë rezultuar, por duke synuar dhënien përgjigje dhe respektimin pretendimeve të pandehurve, në lidhje me këtë çështje konkrete. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në të njëjtë nga sa argumentuar gjykata e shkallës së parë, vlerëson që vendimi nr. 29, datë 16.3.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është i drejtë e duhet lënë në fuqi në një pjesë të tij e duhet të ndryshohet për sa u citua më sipër. Tërësia e provave të marra e të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, krijojnë bindjen edhe te Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, se të pandehurit kanë konsumuar vepra penale të parashikuara nga nenet 284 të KP-së, duke i cituar për secilin prej tyre për sa gjenden fajtorë dhe nga kjo gjykatë duke u paraqitur të dhëna të rëndësishme që shërbejnë për të provuar fajësinë e të pandehurve, përfutur nga provat e marra në këtë gjykim cituar më lart.

8.10 Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në lidhje me caktimin e masave të dënimit për secilin nga të pandehurit në këtë gjykim vlerëson se, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka analizuar drejt rrethanat e faktit që i atribuohen secili prej tyre, rolin që ato kanë pasur në ardhjen e pasojës kriminale, shkallën e fajit që është në formën më të lartë, me dashje direkte, marzhet e dënimit që parashikohen për secilin nga veprat penale për të cilën u gjetën dhe u deklaruan fajtorë të pandehurit, si dhe ekzistencën e rrethanave lehtësuese apo rënduese, në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 47 të KP-së. Në këtë pikë gjykata e apelit çmon me vend të theksojë se gjatë gjykimit në apel nuk konstatoi asnjë rrethanë lehtësuese në rastin konkret për ndryshimin e masës së dënimit, për ulje të mëtejshme të dënimit të caktuar ndaj tyre. Rëndësia e veprave penale, rrethanat konkrete të kryerjes së saj, tregojnë për një rrezikshmëri të lartë të veprës dhe të vetë pandehurve. Në përfundim të këtij gjykimi, në vështrim të nenit 425 të KPP-së, nisur nga fakti që gjykatat e apelit e shqyrtojnë çështjen në tërësi, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, çmoi që vendimi nr. 29, datë 16.3.2018 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duhet të libet në fuqi për pjesët e tjera të tij, si dhe në lidhje me disponimet për provat materiale, konform nenit 190 të KPP-së.”

**9. Kundër vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs Prokurori pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë,** duke kërkuar: “Prishjen e vendimit nr. 60, datë 12.6.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 29, datë 16.3.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”. Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, parashtrihen këto shkaqe:

- Kundërshtojmë vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda në lidhje me deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit Bledar Baboçi (Noka ose Trokthi), të pandehurit Hashim Nelaj dhe të pandehurit Bajram Hidri, për veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal” si dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 333/a/1 e 334/1 të KP-së, me arsyetimin se nuk provohet të ketë kryer veprën penale, por edhe atë pjesë të vendimit që ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, dhe pushimin e çështjes penale për të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj), Lefter Nelaj, Elton Haxhiu Astrit Tafaj Aldo Xhaferri, për sa i takon veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a-1,2 të KP-së.

- Gjykata e Apelit për Krime të Rënda shprehet në vendim se, në analizë të provave të shqyrtuara dhe të verifikuara në këtë proces sipas nenit 152 të KPP-së, duke u mbështetur në tërësinë e akteve të këtij gjykimi, konkludon se vlerësimi i saj juridik dhe fakteve është i njëjtë me konkluzionin e arritur nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke përjashtuar atë për sa i takon deklarimit fajtor të pandehurve për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a i KP-së. Në këtë vendimmarrje gjykata e apelit është mbështetur dhe në një rast të praktikës së zgjidhur nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pasi të pandehurit nuk mund të dënohen dy herë për të njëjtin fakt, sepse ata janë dënuar për ato raste kur veprën e kanë kryer në kuadrin e grupit të strukturuar sipas parashikimit të veprës përkatëse dhe nenit 28/4 e 334/1 të KP-së.

- Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material penal, konkretisht dispozitën e parashikuar nga neni 333/a të KP-së “Grup i strukturuar kriminal”. Parashikimi si vepër penale e veçantë në KP e krijimit, organizimit, drejtimit ose pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, e bën të detyrueshëm për zbatim, si nga organi i ndjekjes penale ashtu dhe nga gjykatat, këtë dispozitë penale, si dhe caktimin e një sanksioni penal për personat që kryejnë këtë vepër penale. Vlerësojmë se asnjë gjykatë nuk mund t’i japë të drejtën vetes që të mos zbatojë një dispozitë penale të parashikuar nga KP-ja, duke mos dënuar, pra duke pushuar çështjen penale për subjektin që ka kryer këtë vepër penale. Parashikimi si vepër penale e veçantë në KP i kësaj forme të veçantë të bashkëpunimit është zgjidhur nga ligjvënësi dhe zbatimi i saj nuk mund të jetë më në diskrecionin e gjykatave, ashtu sikurse është zgjidhur edhe shtimi i dënimit penal për çdo vepër penale që kryhet në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, sipas parashikimeve të nenit 334 të KP-së.

- Zbatimi paralelisht i këtyre dispozitave për autorët që kryejnë vepra penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, nuk përbën gjë të gjykuar. Nuk shohim arsye juridike që do t’i bënte këto dy vepra penale të lidhura dhe në kundërveprim ndërmjet tyre, sa kohë që ato mbrojnë raporte të ndryshme. Krijimi, organizimi ose pjesëmarrja në një grup të strukturuar është vlerësuar se duhet të jetë e dënueshme penalisht sipas nenit 333/a të KP-së, ndërsa neni 334 i tij konsideron si detyrim shtimin e masës së dënimit mbi atë dënim që jepet për veprat penale për ato raste kur pjesëtarët e grupit kriminal kryejnë vepra të ndryshme penale në kuadër të grupit të strukturuar. Dispozita e nenit 334 të KP-së nuk mund të zbatohet vetëm në rast se autori do të akuzohej vetëm për pjesëmarrje në grup të strukturuar, pra kur nuk ka kryer vepra të tjera penale, veç asaj të parashikuar nga neni 333/a të KP-së.

- Në rastin objekt i këtij rekursi, nuk rezulton që të pandehurit të jenë dënuar për ndonjë vepër penale, e cila bashkëpunimin e parashikon si rrethanë rënduese më vete dhe aplikimi i nenit 333/a të KP-së do të konsiderohej si dënim dy herë për të njëjtin fakt apo rrethanë penale. Duke e konsideruar këtë problem si të rëndësishëm, jo thjesht për zgjidhjen e rastit konkret, nëpërmjet këtij rekursi, synojmë që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mundësisht duke zbatuar edhe nenin 438 të KPP-së, të kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara për të njëzuar praktikën gjyqësore.

- Ndërsa në lidhje me pafajësinë e dhënë për të pandehurit, Bledar Baboçi (Noka ose Trokthi), Hashim Nelaj dhe të pandehurin Bajram Hidri, për veprën penale të “Grupit të strukturuar kriminal”, si dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” parashikuar nga nenet 333/a/1 e 334/1 të KP-së, ndryshe nga sa shprehet gjykata e apelit në vendim, mendojmë se nga aktet e dosjes gjyqësore provohet që edhe këta pandehur të kenë kryer veprën penale duke bashkëpunuar në formën e grupit të strukturuar kriminal. Nga provat e analizuara me hollësi nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë në vendim, rezulton se është plotësisht e provuar edhe pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal e të pandehurve të tjerë të deklaruar si të pafajshëm nga gjykata për kryerjen prej tyre të veprës penale në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal.

**10. Kundër vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs i gjykuari Bashkim Kodra, me të cilin ka kërkuar: “Prishjen e vendimit nr. 29, datë 16.3.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimit nr. 60, datë 12.6.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, që kanë deklaruar fajtor të pandehurin Bashkim Kodra, akuzuar për veprën penale “Kultivim i bimëve narkotike”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i KP-së, si të pabazuar përtej çdo dyshimi në prova dhe në ligj. Pushimin e çështjes pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale”.** Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, parashitrohen këto shkaqe:

- Të dyja vendimet e gjykatave të faktit janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe atij procedural penal, janë të padrejtë, të paargumentuar dhe të pabazuar në prova dhe në ligj.

- Gjykata e Krimeve të Rënda nuk është kompetente për gjykimin e kësaj çështje, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, kërkesë e cila nuk është pranuar nga gjykata dhe është rrëzuar prej saj me vendim të ndërmjetëm.

- Të dyja gjykatat kanë bërë një analizë të gabuar të fakteve dhe provave, duke konkluduar në kryerjen e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit Bashkim Kodra. Nuk është provuar me asnjë provë dhe rrethanë ligjore se subjekt i kësaj vepre penale të jetë i gjykuari Bashkim Kodra. Nga gjykimi i çështjes nuk ka rezultuar e provuar se i gjykuari Bashkim Kodra, të ketë kryer veprime të kundërligjshme që ta

implikojnë atë në veprën penale për të cilën ai akuzohet. Në lidhje me akuzën e ngritur për të gjykuarin Bashkim Kodra, nuk ekzistojnë dy nga elementet e domosdoshëm të figurës së veprës penale të “Kultivimit të bimës narkotike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i KP-së që janë ana objektive dhe ajo subjektive. Këto pretendime dhe argumente ligjore ne i kemi parashtruar në konkluzionet tona përfundimtare në të dyja shkallët e gjykimit, por në mënyrë të padrejtë nuk u morën parasysh nga gjykata.

- Të dyja gjykatat e bazojnë vendimin e tyre vetëm në transkriptimin e bisedave telefonike të kryera nga organi akuzës, transkriptime që bazohen vetëm në një episod të shkëputur, të një bisedë jo të plotë të sjellë në cilësinë e provës nga prokuroria, në të cilën nuk përmendet dhe nuk vërtetohet asgjë, përveçse një bisede normale midis dy personave që kanë një marrëdhënie pune, por dhe lidhje familjare krushqie midis tyre. Biseda e kryer midis tyre, pra mes Bashkim Kodrës dhe Aldo Xhaferi nuk është pasqyruar e plotë dhe nuk shfaqet asnjë dyshim për implikim dhe kryerje të veprimeve të paligjshme të këtij të pandehuri. Të dyja gjykatat, në vendimin e tyre përfundimtar, nuk arritën të argumentojnë në mënyrë bindëse me prova ligjore, fakte dhe rrethana konkrete akuzën e ngritur ndaj të pandehurit Bashkim Kodra.

- Faktet dhe veprimet e të pandehurit Bashkim Kodra, nuk përbëjnë vepër penale. Nuk provohet aspak lidhja, raporti apo pozita juridike e të pandehurit Bashkim Kodra me lëndën narkotike të gjetur dhe të sekuestruar nga policia. Çdo dyshim për akuzat e ngritura në drejtim të gjykuarit Bashkim Kodra, nëse nuk provohen dhe argumentohen me prova konkrete, të qarta, të plota dhe ligjore, që ta lidhin atë me veprën penale të kryer dhe me të gjitha provat e tjera, mbetet vetëm në kuadër të dyshimit që sipas procedurës dhe doktrinës shkon në favor të të pandehurit.

- Veprimet e të gjykuarit Bashkim Kodra nuk kanë asnjë lidhje me veprën penale për të cilën ai akuzohet dhe për më tepër veprimet e tij nuk provojnë në asnjë rast se përbëjnë shkak thelbësor për pasojën e veprës penale të kultivimit të bimës narkotike, të cilat duhet të jenë veprime aktive. Të dyja gjykatat, duhet të provonin se veprimet e të pandehurit Bashkim Kodra ishin kryer në mënyrë permanente, dinamike dhe funksionale të lidhura në unison me etapat zinxhir të kryerjes së veprës penale, veprim të cilin gjykatat nuk arritën ta provojnë. Në gjykim nuk u provua dhe nuk pati asnjë provë ligjore që të tregonin se i gjykuari Bashkim Kodra të jetë interesuar si sipërmarrës për të kultivuar bimë narkotike, të ketë gjetur farën si lëndën e parë të kultivimit të kësaj bime, të ketë gjetur parcelën ku do të mbillej ajo bimë, të gjente punëtorët, mjetet me të cilat do të kryhej gjithë operacioni zinxhir i kultivimit të kanabisit, të gjente paratë me të cilën do paguhej fara, mjetet e punës, transporti dhe punëtorët. Nga ana tjetër, nuk u provua që i pandehuri Bashkim Kodra me veprime të kundërligjshme të ketë punuar vetë në vendin e quajtur Shën Mëri, për kultivimin e bimës narkotike dhe prej saj të krijonte përfitime të paligjshme.

- Në lidhje me akuzën e ngritur për të gjykuarin Bashkim Kodra, mungon elementi i dytë i figurës së kryerjes të veprës penale, që është ana subjektive (*mens rea*). Nga të gjitha provat e ndodhur në fashikullin e gjykimit, nuk ka rezultuar asnjë veprim i këtij të gjykuari të jetë kryer me faj, të jetë kryer me dashje dhe të ketë pasur qëllim kriminal. Përkundrazi, si veprim i ligjshëm i të gjykuarit Bashkim Kodra ishte se ai punonte dhe ushtronte detyrën e infermierit në Mamurras, detyrë që e ka kryer me nder dhe përkushtim.

- Gjykatat nuk arritën të provojnë dhe të argumentojnë kryerjen e veprës penale në bashkëpunim. Gjykatat nuk arritën të provojnë se i pandehuri Bashkim Kodra ka tentuar apo të ketë kryer veprën penale të “Kultivimit të bimës narkotike” për të cilën akuzohet. Nuk u provua në gjykim dhe nuk u gjet asnjë gjurmë daktiloskopike apo gjurmë tjetër që t’i përkasë të pandehurit Bashkim Kodra si dhe ta implikojë atë në veprime të paligjshme.

**11. Kundër vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs i gjykuari Lefter Nelaj, me të cilin ka kërkuar: “Prishjen e vendimit nr. 29, datë 16.3.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimit nr. 60, datë 12.6.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe pushimin e çështjes”. Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, parashtrohen këto shkaqe:**

- Vendimet e të dyja gjykatave për deklarimin fajtor të shtetasit Lefter Nelaj janë marrë në kundërshtim me provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore dhe me ligjin material penal.

- Procedimi penal ka filluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin më datë 4.4.2016. Pasi u kryen disa veprime hetimore, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin mbërrin një shkresë e Drejtorisë së SHKBA-së pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme datë 26.8.2016 ku citohej se në kultivimin e bimëve narkotike në malësinë e rrethit Kurbin kultivuesit kanë bashkëpunuar me punonjësit e policisë së Komisarariatit Kurbin prandaj vepra duhet të kualifikohej si e kryer nga grupi i strukturuar kriminal duke shënuar dhe akuzat për nenet 333/a e 334/1 të KP-së. Pas marrjes së kësaj shkrese nga Drejtoria e SHKBA-së pranë Ministrisë së Brendshme, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin nuk ka kryer asnjë veprim tjetër, shpall moskompetencën dhe dërgon çështjen për hetim pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë, e cila e pranon dhe regjistron këtë procedim me akuzat e neneve 284/2, 333/a, 334/1 të KP-së. Kjo prokurori pasi kryen disa veprime hetimore, administrimin e përgjimeve telefonike e vëzhgimeve, pyet disa nga të arrestuarit, vendos të veçojë materialin hetimor në ngarkim të punonjësve të policisë së Komisarariatit Kurbin dhe t'ia dërgojë për kompetencë hetimin prokurorisë së Rrethit Kurbin me arsyetimin se punonjësit e policisë nuk kanë asnjë lidhje me kultivuesit, pra i përjashton nga bashkëpunimi dhe i akuzon vetëm për krimin e shpërdorimit të detyrës me arsyen se nuk kanë ushtruar kontroll në territorin që mbulojnë, e për rrjedhojë janë mbjellë bimë narkotike. Duke e analizuar në këtë këndvështrim, përderisa shkaku që e kualifikoi veprën si të kryer nga grupi i strukturuar kriminal që ishte pjesëmarrja në këtë veprimtari kriminale e punonjësve të Komisarariatit Kurbin ka rënë, pra nuk qëndron, e provuar me vendim të arsyetuar të prokurorit, ka rënë akuza për grupin e strukturuar kriminal. Praktika gjyqësore e deritanishme nuk ka parë raste që mbjellja e bimëve narkotike nga familjet bujqësore duke marrë dhe punëtorë me pagë të jetë kualifikuar grup i strukturuar kriminal.

- Po të marrim në analizë bashkëpunimin midis kultivuesve të bimëve narkotike në rastin konkret rezulton se ata nuk kanë bashkëpunuar për kultivimin e bimëve narkotike pasi secili ka pasur parcelën e vet ku është përkujdesur për kultivimin e bimëve vetë dhe me familjarë e punëtorë të paguar, pra ata mes tyre kanë pasur një marrëveshje e cila ka qenë se kur të shohin punonjësit e policisë që dalin në kontrollin e zonës të njoftonin njëri-tjetrin (kultivuesit) që të largoheshin nga parcelat dhe të mos i kapte policia në parcelë. Realisht kjo marrëveshje ka ekzistuar midis kultivuesve dhe vetëm kjo nuk e bën veprën të kryer nga grup i strukturuar kriminal pasi bashkëpunimi duhet të ekzistojë ndërmjet bashkëpunëtorëve për kryerjen e veprës për të cilën akuzohen kultivimin e bimëve narkotike e jo marrëveshja për të ruajtur nga forcat e policisë kur ata do dalin për kontroll në zonat ku ishte mbjellë kjo bimë, pasi marrëveshja për të ruajtur nga jashtë policinë nuk përbën vepër penale më vetë e për këtë nuk ka ndonjë akuzë nga prokuroria. Nuk ka logjikë që të trajtohet vepra e kryer prej anëtarëve të së njëjtës familje (daja, xhaxhai dhe nipi) në rastin konkret si vepër e kryer nga grupi i strukturuar kriminal.

- Të dyja gjykatat në vendimet e tyre nuk arsyetojnë se ku është zona e mbjellë me hashash dhe ku është banesa e secilit prej të dënuarve, në mënyrë që të ketë një logjikë në përgjegjësinë individuale lidhur me parcelat e mbjellja me hashash. Përfundimisht, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, por edhe ajo e Apelit e Krimeve të Rënda Tiranë, kanë dhënë një vendim që nuk është i mbështetur në provat ligjore të administruara në seancë gjyqësore.

**12. Kundër vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të rënda Tiranë, ka ushtruar rekurs i gjykuari Hashim Nelaj, me të cilin ka kërkuar: Prishjen e vendimit nr. 29, datë 16.3.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimit nr. 60, datë 12.6.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe pushimin e çështjes".** Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, parashtrohen këto shkaqe:

- Vendimet e të dyja gjykatave, për deklarimin fajtor të shtetasit Hashim Nelaj janë marrë në kundërshtim me provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore dhe me ligjin material penal. Vendimet janë tërësisht të paligjshme, alogjike dhe të pabazuara në prova.

- Procedimi penal ka filluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin më datë 4.4.2016. Pasi u kryen disa veprime hetimore, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin mbërrin një shkresë e Drejtorisë së SHKBA-së pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme datë 26.8.2016 ku citohej se në kultivimin e bimëve narkotike në malësinë e Rrethit Kurbin kultivuesit kanë bashkëpunuar me punonjësit e policisë së Komisarariatit Kurbin prandaj vepra duhet të kualifikohej si e kryer nga grupi i strukturuar kriminal duke shënuar dhe akuzat për nenet 333/a e 334/1 të KP-së. Pas marrjes së kësaj shkrese nga Drejtoria e

SHKBA-së pranë Ministrisë së Brendshme, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin nuk ka kryer asnjë veprim tjetër, shpall moskompetencën dhe dërgon çështjen për hetim pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë, e cila e pranon dhe regjistron këtë procedim me akuzat e neneve 284/28,333/a, 334/1 të Kodit Penal. Kjo prokurori pasi kryen disa veprime hetimore, administrimin e përgjimeve telefonike e vëzhgimeve, pyet disa nga të arrestuarit, vendos të veçojë materialin hetimor në ngarkim të punonjësve të policisë së Komisarariatit Kurbin dhe t'ia dërgojë për kompetencë hetimin prokurorisë së Rrethit Kurbin me arsyetimin se punonjësit e policisë nuk kanë asnjë lidhje kultivuesit, pra i përjashton nga bashkëpunimi dhe i akuzon vetëm për krimin e shpërdorimit të detyrës me fabulën se nuk kanë ushtruar kontroll në territorin që mbulojnë, e për rrjedhojë janë mbjellë bimë narkotike. Duke e analizuar në këtë këndvështrim përderisa shkaku që e kualifikoi veprën si të kryer nga grupi i strukturuar kriminal që ishte pjesëmarrja në këtë veprimtari kriminale e punonjësve të Komisarariatit Kurbin ka rënë, pra nuk qëndron, e provuar me vendim të arsyetuar të prokurorit, ka rënë akuza për grupin e strukturuar kriminal. Praktika gjyqësore e deri tanishme nuk ka parë raste që mbjellja e bimëve narkotike nga familjet bujqësore duke marrë dhe punëtorë me pagë të jetë kualifikuar grup i strukturuar kriminal.

- Po të marrim në analizë bashkëpunimin midis kultivuesve të bimëve narkotike në rastin konkret rezulton se, ata nuk kanë bashkëpunuar për kultivimin e bimëve narkotike pasi secili ka pasur parcelën e vet ku është përkujdesur për kultivimin e bimëve vetë dhe me familjarë e punëtorë të paguar, pra ata mes tyre kanë pasur një marrëveshje e cila ka qenë që, kur të shohin punonjësit e policisë që dalin në kontrollin e zonës të njoftonin njëri-tjetrin (kultivuesit) që të largoheshin nga parcelat dhe të mos i kapte policia në parcelë. Realisht kjo marrëveshje ka ekzistuar midis kultivuesve dhe vetëm kjo nuk e bën veprën të kryer nga grup i strukturuar kriminal pasi bashkëpunimi, duhet të ekzistojë ndërmjet bashkëpunëtorëve për kryerjen e veprës për të cilën akuzohen kultivimin e bimëve narkotike e jo marrëveshja për të ruajtur nga forcat e policisë kur ata do dalin për kontroll në zonat ku ishte mbjellë kjo bimë, pasi marrëveshja për të ruajtur nga jashtë policinë nuk përbën vepër penale më vetë e për këtë nuk ka ndonjë akuzë nga prokuroria. Nuk ka logjikë që të trajtohet vepra e kryer prej anëtarëve të njëjtës familje (daja, xhaxhai dhe nipi) në rastin konkret si vepër e kryer nga grupi i strukturuar kriminal.

- Të dyja gjykata në vendimet e tyre nuk arsyetojnë se ku është zona e mbjellë me hashash dhe ku është banesa e secilit prej të dënuarve në mënyrë që të ketë një logjikë në përgjegjësinë individuale lidhur me parcelat e mbjella me hashash.

**13. Kundër vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të rënda Tiranë, ka ushtruar rekurs i gjykuari Elton Haxhiu, me të cilin ka kërkuar: “Prishjen e vendimit nr. 29, datë 16.3.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimit nr. 60, datë 12.6.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe pushimin e çështjes”.** Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, parashtrohen këto shkaqe:

- Vendimet e të dyja gjykatave, për deklarimin fajtor të shtetasit Elton Haxhiu janë marrë në kundërshtim me provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore dhe me ligjin material penal. Vendimet janë tërësisht të paligjshme e të pabazuara në prova dhe alogjikë.

- Procedim penal ka filluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin më datë 4.4.2016. Pasi kryen disa veprime hetimore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin mbërrin një shkresë e Drejtorisë së SHKBA-së pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme datë 26.8.2016 ku në të citohej se në kultivimin e bimëve narkotike në malësinë e Rrethit Kurbin kultivuesit kanë bashkëpunuar me punonjësit e policisë së Komisarariatit Kurbin prandaj vepra duhet të kualifikohet si e kryer nga grupi i strukturuar kriminal duke shënuar dhe akuzat për nenet 333/a e 334/1 të Kodit Penal. Pas marrjes së kësaj shkrese nga Drejtoria e SHKBA-së pranë Ministrisë së Brendshme, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin nuk ka kryer asnjë veprim tjetër, shpall moskompetencën dhe dërgon çështjen për hetim pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë e cila e pranon dhe regjistron këtë procedim me akuzat e neneve 284/1, 28, 333/a, 334/1 të KP-së. Kjo prokurori pasi kryen disa veprime hetimore, administrimin e përgjimeve telefonike e vëzhgimeve, pyet disa nga të arrestuarit, vendos të veçojë materialin hetimor në ngarkim të punonjësve të policisë së Komisarariatit Kurbin dhe t'ia dërgojë për kompetencë hetimin prokurorisë së Rrethit Kurbin me arsyetimin se punonjësit e policisë nuk kanë asnjë lidhje kultivuesit, pra i përjashton nga bashkëpunimi dhe i akuzon vetëm për krimin e shpërdorimit të detyrës me fabulën se nuk kanë ushtruar kontroll në

territorin që mbulojnë, e për rrjedhojë janë mbjellë bimë narkotike. Duke e analizuar në këtë këndvështrim përderisa shkak që e kualifikoi veprën si të kryer nga grupi i strukturuar kriminal që ishte pjesëmarrja në këtë veprimtari kriminale e punonjësve të Komisarariatit Kurbin ka rënë, pra nuk qëndron, e provuar me vendim të arsyetuar të prokurorit, ka rënë akuza për grupin e strukturuar kriminal. Praktika gjyqësore e deritanishme nuk ka parë raste që mbjellja e bimëve narkotike nga familjet bujqësore duke marrë dhe punëtorë me pagë të jetë kualifikuar grup i strukturuar kriminal.

- Po të marrim në analizë bashkëpunimin midis kultivuesve të bimëve narkotike në rastin konkret rezulton se ata nuk kanë bashkëpunuar për kultivimin e bimëve narkotike pasi secili ka pasur parcelën e vet ku është përkujdesur për kultivimin e bimëve vetë dhe me familjarë e punëtorë të paguar, pra ata mes tyre kanë pasur një marrëveshje e cila ka qenë që kur të shohin punonjësit e policisë që dalin në kontrollin e zonës të njoftonin njëri-tjetrin (kultivuesit) që të largoheshin nga parcelat dhe të mos i kapte policia në parcelë. Realisht kjo marrëveshje ka ekzistuar midis kultivuesve dhe vetëm kjo nuk e bën veprën të kryer nga grup i strukturuar kriminal pasi bashkëpunimi, duhet të ekzistojë ndërmjet bashkëpunëtorëve për kryerjen e veprës për të cilën akuzohen, kultivimin e bimëve narkotike e jo marrëveshja për t'u ruajtur nga forcat e policisë kur ata të dalin për kontroll në zonat ku ishte mbjellë kjo bimë, pasi marrëveshja për të ruajtur nga jashtë policinë nuk përbën veprë penale më vete e për këtë nuk ka ndonjë akuzë nga prokuroria. Nuk ka logjikë që të trajtohet vepra e kryer prej anëtarëve të së njëjtës familje (daja, xhaxhai dhe nipi) në rastin konkret si veprë e kryer nga grupi i strukturuar kriminal.

- Të dyja gjykatat në vendimet e tyre nuk arsyetojnë se ku është zona e mbjellë me hashash dhe ku është banesa e secilit prej të dënuarve në mënyrë që të ketë një logjikë në përgjegjësinë individuale lidhur me parcelat e mbjella me hashash.

**14. Kundër vendimit nr. 60, datë 12.6.2018 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë kanë ushtruar rekurs të gjykuarit Lavdim Neziri (Nelaj), Lefter Nelaj, Hashim Nelaj, Sami Balloku dhe Bajram Hidri, duke kërkuar: “Prishjen e vendimeve dhe kthimin e akteve për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me tjetër trup gjyqësor”. Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, parashtrohen këto shkaqe:**

- Nuk ka “grup të strukturuar kriminal” në këtë procedim penal veçanërisht pas vendimit të Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, që shpalli moskompetencën e këtij organi për 4 punonjësit e policisë së rrethit Kurbin ku në këtë vendim akuza citon se “...punonjësit e policisë së komisarariatit Kurbin nuk kanë asnjë lidhje me kultivuesit e bimëve narkotike, por duhet të përgjigjen për veprën penale të shpërdorimit të detyrës sipas nenit 248 të KP-së me fabulën se nuk kanë ushtruar kontrolle në zonën që mbulonin në Rrethin e Kurbin ku është mbjellë bima narkotike”. Kultivimi i bimëve narkotike nga një parcelë me punëtorë të paguar dhe anëtarë të familjes bujqësore nuk të çon kurrë te grupi i strukturuar kriminal. Fajësia penale për Lavdim Neziri po të shqyrtohen me kujdes aktet e dosjes gjyqësore, përgjimet telefonike mbetet i paprovuar, madje provohet pafajësia e tij. Për të gjithë të gjykuarit duhet të pushohet akuza e kryerjes së veprës nga anëtari i grupit të strukturuar kriminal sipas nenit 334/1 të KP-së, pasi nuk ka anëtarë e pjesëmarrës të grupit të strukturuar kriminal kur grupi nuk ekziston. Në rastin konkret Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda me vendim ka pushuar ekzistencën e grupit të strukturuar kriminal si për organizatorët e drejtuesit sipas nenit 330/a-1 të KP-së ashtu edhe për pjesëmarrësit në grupin e strukturuar kriminal sipas nenit 330/a-2 të KP-së dhe pas gjithë këtyre nuk dimë e nuk mund ta mendojmë se ku i gjen pjesëmarrësit dhe anëtarët e grupit të strukturuar kriminal që kanë kryer veprën penale duke i dënuar në bazë të nenit 341/1 të KP-së. Ky është një qëndrim tërësisht i paligjshëm e shumë alogjik i kësaj gjykate. Të pandehurit Hashim Neli e Bajram Hidri kanë qenë të punësuar në shërbim të bimëve narkotike të mbjella nga Lefter Neli se janë nipat e tij dhe nuk mund të quhen bashkëpunëtorë në krim.

**15. Kundër vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë kanë ushtruar rekurs të gjykuarit Astrit Tafaj dhe Aldo Xhaferri, duke kërkuar: “Ndryshimin e vendimeve dhe deklarimin e pafajshëm të tyre dhe heqjen e masës së sigurimit dhe lirin e menjëhershme”. Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, parashtrohen këto shkaqe:**

- Të dyja vendimet objekt rekursi janë të padrejta pasi janë pasojë e zbatimit të gabuar të ligjit material e të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të KEDNJ-së, të

Kushtetutës së RSH-së, të njësimimit dhe praktikës gjyqësore, madje në kundërshtim me vetë vendimet e Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 38, datë 11.5.2015 të Kolegjit Penal të GJL-së dhe nr. 4/2012 të Kolegjere të Bashkuara të GJL-së).

- Gjykata pranon në arsyetim se mungojnë provat për akuzën e grupit të strukturuar kriminal dhe vendos pushimin e çështjes, dhe nga ana tjetër në kundërshtim me këtë pjesë të vendimit dhe me sa arsyeton dhe vendos në mënyrë kontradiktore duke i deklaruar fajtorë për bashkëpunim në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal. Ky është *non sens*, se përderisa nuk ka grup të strukturuar kriminal nuk mund të ketë as bashkëpunim në formën e këtij grupi.

- Gjykata ka shkelur barazinë para ligjit duke shkelur standardet jo vetëm duke krahasuar këtë rast në tërësi me vendimet e tjera të ngjashme, madje të dhëna edhe nga Gjykata e Lartë, por kemi shkelje të standardeve edhe në të njëjtin proces.

- Po të pranojmë për një moment të drejtë arsyetimin e gjykatës përcaktohet se Astrit Tafaj dhe Aldo Xhaferri janë përfshirë më pas në shërbim të bimëve narkotike, si punëtorë dhe nuk janë në rolin as të organizuesit dhe as të financuesit, pra po sipas përmbajtjes së arsyetimit të gjykatës, gjykata vendos në kundërshtim të hapur me sa ka arsyetuar. Gjykata bën të njëjtin cilësim të akuzave dhe jep dënim më të rëndë ose pothuajse të barabartë me organizatorët apo financuesit. Ky fakt provon se gjykata ka dhënë një vendim të gabuar, pra gjykata ka shkelur barazinë para ligjit. Nuk kemi të bëjmë në asnjë moment dhe gjykata nuk paraqiti asnjë lloj prove se kemi pasur dijeni për ekzistencën e ndonjë veprimi të paligjshëm, marrëdhëniet janë thjesht shoqërore për shkak të lidhjeve familjare dhe nuk ka asnjë element juridik as për bashkëpunim të thjeshtë, ndërsa akuza për grup të strukturuar kriminal është një absurditet.

- Në vendimet objekt rekursi mungon arsyetimi për çdo rast e konkretisht për Aldo Xhaferin dhe Astrit Tafajin në mënyrë individuale, por arsyetohet në përgjithësi në mënyrë sipërfaqësore në një kohë kur përgjegjësia është individuale. Pra, mungon arsyetimi çka e bën këtë vendim të paligjshëm në kundërshtim me vendimin përkatës të Gjykatës Kushtetuese. Shkaku i mungesës së arsyetimit është i lidhur me faktin se nuk ka as edhe një prove.

- Në vlerësimin një nga një e në tërësi kemi të bëjmë me një vendim të padrejtë që penalizon dhe shkel të drejtat e njeriut, shkel barazinë para ligjit, dënon pa prova, duke përbërë në vetvete një vendim që shpreh funksionimin e paligjshëm të drejtësisë. Të dyja vendimet janë të pabazuara në prova dhe ligj në kundërshtim me vetë aktet e procedimit penal nr. 256 të vitit 2016, filluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe numri 147/3 i vitit 2016 filluar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë. Duke vlerësuar një nga një e në tërësi nuk ka asnjë provë që të provojë akuzën e ngritur, madje çështja mbetet në kushtet e indicieve të cilët nuk kanë konkluduar në prova që provojnë një akuzë absurde që ka çuar në penalizim të padrejtë të të mbrojturve prej meje Astrit Tafaj dhe Aldo Xhaferri.

- Konkluzioni i organit të akuzës mbi bazën e së cilës mbështetet gjykata në dy vendimet objekt rekursi në lidhje me akuzën dhe vendimin e marrë për të pandehurit, është një absurditet për arsye se në kuptimin formal e juridik të këtij konkluzioni i mungojnë faktet, provat dhe arsyetimi. Organi i akuzës dhe gjykatat nuk paraqesin asnjë provë për të vërtetuar pronësinë e parcelës, pronësinë e bimëve, nuk është gjetur duke punuar në parcelë, nuk është filmuar pra nuk ka asnjë provë që ta lidhë me atë parcelë, të cilën padrejtësisht ia faturon, madje as nuk ka pasur dijeni për ekzistencën e parcelës dhe të bimëve për të cilën bëhet fjalë. Duhet të veçojmë dhe një moment, i akuzuari Aldo Xhaferri një ditë para për të cilën bëhet fjalë ka qenë për t'u nisur për të punuar në Greqi, fakt që tregon se s'ka asnjë lidhje për sa akuzohet. Gjykata duhet të ishte thelluar se pse organi i akuzës nuk ka kryer ekzaminimin e gjurmëve (për identifikimin e personit) kërkesë e cila është kërkuar gjatë veprimeve hetimore ku njëkohësisht është kërkuar dhe pushimi i çështjes. Nuk është e vërtetë që janë arrestuar në flagrancë pasi është paraqitur vetë në organin e policisë dhe ky fakt pasqyrohet në aktet e procedimit penal. Sa për përgjimet e bisedave telefonike në asnjë moment nuk bëhet fjalë për biseda komprometuese që të justifikojnë akuzën.

- Akuzat e ngritura dhe vendimi objekt ankimi janë të pabazuara në prova dhe ligj dhe organi i akuzës duhej t'i kishte pushuar që gjatë veprimeve hetimore, ndërsa gjykata duhet t'i kishte deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat e ngritura për arsyet e mëposhtme: Nuk ka asnjë element juridik për veprat penale për të cilat akuzohet për arsye se nuk ka asnjë provë të qartë ligjore që të justifikojë akuzat e ngritura, madje kjo çështje duhet të jetë objekt gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Nuk është

as ligjore dhe as logjike fakti se organi i akuzës e ka cilësuar si “Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal” etj., duke e lidhur se ky grup prej 12 të bashkuarit kanë bashkëpunuar me punonjësit e policisë ndërkohë që këta të fundit gjykohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin (pas ndarjes së çështjes) për akuzën “Shpërdorim detyrë”.

- Nuk ka asnjë provë që përbën dyshim të arsyeshëm se jam autor i veprës penale për të cilën dyshohem, madje nuk ka asnjë fjalë, asnjë indicie për të dyshuar tek unë për asnjë vepër penale. Është ushtruar kontroll i befasishtëm në banesën time dhe rreth saj dhe nuk është gjetur asgjë e paligjshme (asnjë shenjë apo mbetje të bimëve narkotike), përveç dy thasëve me bimë medicinale.

- Tabulatet, përmbajtja e tyre nuk përbën dyshime për akuzat ndaj meje, por janë interpretime në kundërshtim me të vërtetën, por siç duket janë munduar të lidhin bisedën me persona të tjerë duke penalizuar bisedën nga ana formale dhe jo përmbajtjen siç lartpërmenda.

- Nuk ka asnjë provë për veprën penale të kultivimit të bimës narkotike për arsye se nuk është kapur nuk është filmuar nuk është gjetur asgjë në shtëpi, parcela dhe bimët e gjetura nuk janë të tyre, mungesa e dijenisë për ekzistencën e bimës narkotike dhe si e tillë mungon çdo element juridik për këtë vepër penale. Ndërsa në lidhje me akuzën pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal parashikuar nga neni 332/a/2 të KP-së, mungon ana objektive dhe subjektive e veprës penale për të cilën akuzohen, mungon dijenia dhe dashja si element të domosdoshëm për këtë vepër penale për më tepër siç theksuam as tabulatet telefonike dhe as rrethanat nuk provojnë asgjë në këtë akuzë. Ndërsa shtimin e dënimit për kryerjen e veprës penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal parashikuar nga neni 333/a/1 dhe 334 i KP-së është një absurditet tjetër pa sens logjik dhe juridik, në një kohë kur për arsyet që kemi cituar më sipër të cilat janë fakte mungon çdo element juridik për të ngritur një akuzë të tillë, madje vlen të theksojmë faktin se as në diskutimin përfundimtar të organit të akuzës nuk bëhet asnjë analizë juridike e rrethanave e fakteve, por trajtohen në mënyrë të shkëputur dhe mekanike. Siç duket, organi i akuzës mund të jetë i vetëdijshëm për padrejtësinë dhe janë ngritur akuzat për të justifikuar mbajtjen e kësaj çështjeje për hetim pranë këtij organi dhe kësaj gjykate për arsye se kjo çështje duhet të ishte gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Madje duhet të theksojmë se asnjë veprim me rëndësi hetimore nuk është kryer pranë këtij organi me gjithë kërkesat tona të herëpashershme për arsye se kemi vënë në dijeni se jemi të pafajshëm dhe po paralizohemi padrejtësisht.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë**

16. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”), në radhë të parë vlerëson se rekursat e paraqitura nga prokuroria dhe të gjykuarit plotësojnë kërkesat formale të pranueshmërisë dhe janë depozituar brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të KPP-së (ligji/dispozita në fuqi në kohën e depozitimit të tij). Prokuroria dhe të gjykuarit janë njoftuar për rekursat respektive. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP-së. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, sipas ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të rekursit, parashikonte se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal; për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi ose për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

17. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji vlerësoi se në rekursat e depozituara si nga prokuroria, ashtu edhe nga të gjykuarit, ngrihen çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432 pika “1”, shkronja “a” të KPP-së. Kolegji, nga verifikimi i qëndrimit të mbajtur nga (ish) gjykatat për krime të rënda (shkallë e parë dhe apel) në rastin konkret, në raport me raste të tjera të ngjashme ku janë trajtuar çështje të zbatimit të dispozitave penale materiale, konkretisht nenet 333, 333/a dhe 334 të KP-së (referuar këtu edhe qëndrimeve të Kolegjit Penal), konstaton se ka qëndrime të ndryshme në praktikën gjyqësore. Koncretisht, në disa vendime Kolegji Penal ka çmuar të drejtë qëndrimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda që ka disponuar për prishjen dhe pushimin e çështjes penale për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” sipas nenit 333/a të KP-së, duke argumentuar se krijimi apo pjesëmarrja në një grup të strukturuar kriminal sipas përcaktimeve të neneve 28.a dhe 333/a të KP-së, përthithet nga aplikimi i nenit 334/1 i këtij Kodi (*shih vendimin nr. 00-2013-1741 (315), datë 22.11.2012; vendimin nr. 00-2022-1619 (331), datë 15.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Në raste të tjera, Kolegji ka mbështetur vendimarrjet e

gjykatave për krime të rënda (shkallë e parë ose apel), ku është disponuar për deklarimin fajtor të gjykuarve si për veprën penale të parashikuar nga neni 333/a i KP-së, ashtu edhe për zbatimin e nenit 334 të këtij Kodi si shtesë dënimi kur vepra penale konkrete është kryer në kuadër të kësaj formë të veçantë bashkëpunimi. Në këto raste, gjykata e faktit dhe Kolegji Penal kanë argumentuar se, vepra penale e krijimit apo pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal e parashikuar nga neni 333/a i KP-së, konkurren me veprat e tjera të kryera nga ana e grupit të strukturuar dhe nuk përthithet nga këto vepra (shih vendimin nr. 00-2013-1550 (200), datë 12.6.2013; vendimin nr. 00-2023-102, datë 19.1.2023; vendimin nr. 00-2023-201 (42), datë 2.2.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

18. Në kuadër të këtyre qëndrimeve të ndryshme, në referim të nenit 438 të KPP-së, i cili parashikon se “Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nënjen e procedurës së gjyqimit për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore”, Kolegji, në dhomë këshillimi, në datë 7.12.2023, vendosi: “Kalimin e çështjes penale nr. 56280-01562-00-2018, datë regjistrimi 1.10.2018, për shqyrtim në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore”. Në këto rrethana dhe referuar shkaqeve të parashtruar nga palët në rekurset respektive, Kolegji identifikoi dhe vlerësoi me rëndësi të njësojë praktikën gjyqësore në lidhje me çështjet:

1. Si duhet të trajtohet neni 334 i KP-së në raport me nenin 28, paragrafët 5 dhe 6 të KP-së?

2. A konkurrojnë nenet 333, 333/a me nenin 334 të KP-së, në referim të parimit të mosgjyqimit dy herë për të njëjtin fakt penal (neni 7 i KPP-së)?

3. Neni 334, a mund të zbatohet veçmas si vepër penale autonome, apo shoqëron dispozitën konkrete penale që parashikon faktin që cilësohet si vepër penale, e kryer në kuadër të organizatës kriminale ose grupit të strukturuar kriminal?

### III. Qëndrimet njësuere të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

19. Në lidhje me 3 (tri) çështjet e shtruara për njësim, në seancë gjyqësore, përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme, prokurorët Adnand Xholi dhe Ened Nakuçi, mbajtën këto qëndrime (parashtruar më poshtë në mënyrë të përmbledhur):

1) Dënimi i parashikuar nga neni 334 i KP-së është një shtesë dënimi, dispozitë e cila pavarësisht se ndodhet në pjesën e posaçme të Kodit Penal, nuk konsiderohet si vepër penale me vete, por një dënim i shtuar për shkak të një rrethane, që është ajo e pjesëmarrjes në ndonjë organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal, apo krijimit të organizatës/grupit kriminal.

2) Sa i përket pyetjes së dytë, konkludojmë se në rastin kur janë kryer veprat penale nga pjesëtarët e grupit të strukturuar kriminal në kuadër të realizimit të një plani kriminal, kemi konkurrim ndemjet këtyre veprave penale konkrete të parashikuara në pjesën e posaçme të KP-së (neni 334 i këtij Kodi) me veprën penale “Grup i strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal (krijimi apo pjesëmarrja). Kjo, pasi ligjvënësi ka paraparë që veprimet përgatitore që në thelb lidhen me veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” në formën e krijimit apo pjesëmarrjes, t’i parashikojë si vepër penale më vete. Një argument tjetër se përse dënimi i shtuar sipas nenit 334 të KP-së, për kryerjen e veprave penale në kuadër të grupit/organizatës kriminale, nuk bie ndesh me parimin *në bis in idem*, i ka dhënë përgjigje Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 42, datë 5.4.2022.

3) Së fundi, pavarësisht se indirekt i është kthyer përgjigje dhe pyetjes së tretë, çmojmë se kjo dispozitë, neni 334 i KP-së, nuk mund të qëndrojë si vepër penale më vete.

20. Mbrojtësit e të gjykuarve (në realizimin e mbrojtjes për secilin nga të gjykuarit), në lidhje me çështjet e shtruara për njësim, mbajtën qëndrimet si më poshtë vijon:

20.1 Mbrojtësi i të gjykuarve Aldo Xhaferri dhe Astrit Tafaj, Av. Ali Paja, në lidhje me pyetjet e shtruara për njësim mbajti këto qëndrime (referim i përmbledhur):

- Vendimi i gjykatës së apelit që ka vendosur pushimin e çështjes për grupin e strukturuar kriminal është e drejtë. Unë konstatoj se nëse do të kishte dhënë dënim siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë mendoj se do të gjykohehin dy herë. Duhet të shqyrtohet thelbi i çështjes në fund të fundit duhet t’i jepet përgjigje duke i dhënë unifikim në lidhje me subjektin i paraprihet të drejtave të njeriut, por dhe provat konkrete. Në këtë kuadër theksoj se për të dy të mbrojturit prej meje në mënyrë absolute jo vetëm që është e parashikuar, por nuk thuhet asgjë konkrete që i implikon, pra mendoj se vendimi bie ndesh me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për faktin se nuk ka arsyetim pra nuk ka arsyetim për veprën e të dy të pandehurve. Aty vërtet ka qenë një grup i madh i bashkuar mekanikisht pa asnjë lidhje me njeri tjetrin pa

asnjë njohje për ta cilësuar si grup të strukturuar kriminal për të justifikuar dënimin. Sa i përket vendimit të Gjykatës së Apelit unë mendoj se e kanë interpretuar drejt kur ka vendosur pushimin e çështjes për pjesëmarrjen në grup të strukturuar kriminal, por ka vepruar në mënyre të gabuar në rastin konkret sa i përket deklarimit fajtor. Në këto rrethana unë i kërkoj gjykatës të ndryshoj vendimet e të dyja gjykatave dhe deklarimin e pafajshëm të dy të pandehurve të mbrojtur prej meje.

20.2 Mbrojtësi i të gjykuarit Bledar Baboçi, Av. Saimir Vishaj, në lidhje me pyetjet e shtruar për njësim mbajti këtë qëndrim:

- Në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për njësim, mbrojtësit theksoi se duke u nisur dhe nga fakti se këto dy dispozita qëndrojnë të ndara, ku bashkëpunimi i veçantë i parashikuar në nenin 28 të KP-së parashikohet në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, ndërsa në nenin 334 të KP-së parashikohet në pjesën e posaçme të Kodit Penal, mendojmë se këto dy figura të veprës penale duhet të qëndrojnë të ndara nga njëra tjetra, pasi ato nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën dhe aplikimi i të dyja dispozitave njëkohësisht sjell një rëndim artificial të pozitës procedurale të autorit të veprës penale. Nuk mund të bëhet cilësimi ligjor i veprës një herë sipas dispozitës të përgjithshme dhe një herë sipas dispozitës së posaçme të KP-së (*shih vendimin nr. 68, datë 29.2.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

- Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, mendojmë se nenet 333 dhe 333/a nuk konkurrojnë me nenin 334 të KP-së, për pasojë nuk mund të zbatohen njëkohësisht për të njëjtin fakt penal. Parimi i ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale përbën bazën themelore logjike dhe juridike të zbatimit të ligjit, në rastin kur kemi të bëjmë me praninë e një pluraliteti normash inkriminuese, të cilat në pamje të parë duken të gjitha si të zbatueshme, por që vetëm njëra prej tyre gjen zbatim. Në këtë rast duhen zbatuar konkluzionet e vendimit unifikues nr. 3, datë 2.11.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Vlerësojmë se do të ishte e paarsyeshme që për të njëjtat fakte objektive një person të dënohej dy herë.

- Në lidhje me pyetjen e tretë, në vlerësimin tonë vepra penale “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334 të KP-së nuk mund të qëndrojë si vepër penale autonome, pasi kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një vepre penale “mëmë” në mënyre që të aplikohet kjo dispozitë.

20.3 Mbrojtësi i të gjykuarve Lefter Nelaj, Hashim Nelaj, Elton Haxhiu, Lavdim Neziri (Nelaj), Av. Marash Ibraj, në lidhje me pyetjet e shtruar për njësim parashtroi sa më poshtë vijon: - Lidhur me zbatimin e nenit 334 të KP-së, mendojmë që zbatimi i këtij neni në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, është antikushtetues. Çfarë do të thotë që nuk mund të kemi zbatim matematik të këtij neni sepse ky nen cenon nenet 17, 42 dhe 135 të Kushtetutës, pasi i heq gjykatës autoritetin e marrjes së vendimit.

- Në lidhje me pyetjen e dytë, qëndrimi ynë si mbrojtës është i ditur dhe i përsëritur, por mendoj se përgjigje juridike të saktë dhe shtruese këtij problemi i ka dhënë vendimi nr. 37, datë 15.3.2015, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (citim i vendimit). Kjo do të thotë që subjekti i veprës penale nuk mund të deklarohet fajtor edhe për veprën penale të nenit 333/a edhe atë të nenit 334/1 në lidhje me nenin 28 dhe veprën e kryer. Kjo pasi në këtë rast do të ishim para një dënimi të trefishtë (shih edhe vendimin unifikues nr. 3/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).

- Në lidhje me pyetjen e tretë, në bindjen tonë, pa pasur një vepër të kryer nuk mund të ketë as referim të nenit 334 të KP-së. Rezulton se neni 334 i KP-së është një dispozitë referuese duke u bashkuar me nenin përkatës që parashikon veprën penale të kryer në kuadër të bashkëpunimit të posaçëm për efekt të caktimit të dënimit.

20.4 Mbrojtësi i caktuar kryesisht për të gjykuarit Sami Balloku dhe Bajram Hidri, Av. Sokol Kepi, në lidhje me çështjet e shtruar për njësim, mbajti këto qëndrime:

- Secila nga këto dispozita, neni 333 dhe 333/a të KP-së, ashti si dhe ato të organizatës terroriste dhe bana e armatosur, janë vepra penale formale dhe nuk kërkojnë ardhjen e pasojave. Thënë ndryshe, deri në momentin kur veprimet e pjesëtarëve të organizatës apo grupit të strukturuar kriminel kanë mbetur në krijimin dhe pjesëmarrjen në këtë formë të posaçme bashkëpunimi, por nuk janë konkretizuar me kryerjen e një vepre penale, ato mbajnë përgjegjësi sipas neneve 333 dhe 333/a të KP-së.

- Në rastin konkret ndodhemi përpara një konflikti në dukje të normave penale dhe jo të konkurrimit të veprave penale, prandaj për të kryer një cilësim të saktë të dispozitës së zbatueshme duhet t'i referohemi parimeve të: a) specialitetit (*lex specialis derogat legi generali*); b) subsidiaritetit (*lex primaria derogat legi subsidiaria*), dhe c) përthithjes (*lex consumens derogat legi consumptae*). Mbi bazën e këtyre parimeve, rezulton se nenet 333, 333/a dhe 334 të KP-së mbrojnë të njëjtën marrëdhënie juridike, por në rastin e një përshkallëzimi të aktivitetit kriminal të anëtarëve të organizatës apo të grupit të strukturuar kriminal, duhet të zbatohet neni 334 i KP-së, i cili përthith nenet 333 dhe 333/a të këtij Kodi. Ky konkluzion është në harmoni me orientimet e vendimit unifikues nr. 3/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Për sa më sipër, edhe në lidhje me çështjen e fundit të shtruar për njësim, vetëkuptohet që figura e veprës penale “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 334 i KP-së nuk mund të trajtohet si një vepër penale autonome, pasi duhet të shoqërojë veprën penale konkrete të kryer nga pjesëtarët e organizatës kriminale ose të grupit të strukturuar.

20.5 Mbrojtësja e caktuar kryesisht për të gjykuar Bashkim Kodra, Av. Sonila Çekrezi, parashtrori se faktet dhe veprimet që i atribuohen të gjykuarit Kodra nuk përbëjnë vepër penale. Nga të dyja gjykatat janë pranuar apriori konkluzionet e organit të akuzës pa një analizë të plotë të fakteve, rrethanave dhe provave të administruara në gjykimin e çështjes. Në këtë kuptim, Kolegji Penal i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat që të marrë një rol aktiv, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta.

21. Kolegji, në përgjigje të pyetjeve të shtruara për njësim, në kushtet e një lidhje organike dhe shkakësore ndërmjet tyre, në rend kronologjik me njëra-tjetrën, vlerëson të analizojë në tërësi argumentet ligjore, praktikën jurisprudenciale vendase dhe të huaj, si dhe vështirimet doktrinare që mundësojnë konkludimin mbi kuptimin e duhur të formës së veçantë të bashkëpunimit penal; përgjegjësinë penale që ngarkon ligji penal për këtë formë bashkëpunimi sipas neneve 28 (5)(6) dhe 333, 333/a të KP-së; natyrën e nenit 334 të KP-së në raport krahasimor me elementet që duhet të përmbajë një vepër penale për t'u konsideruar e tillë. Ky trajtim/argumentin në vlerësimin e Kolegjit njëherësh nxjerr përgjigjet për tri çështjet e shtruara për njësim, pasi natyra e dispozitës që përmban neni 334 i KP-së dikton konkluzionin mbi konkurrueshmërinë e saj me nenet 333 dhe 333/a dhe, si rrjedhojë, edhe autonominë ose jo të saj në relacion me dispozitën konkrete penale që parashikon faktin që cilësohet si vepër penale, e kryer në kuadër të organizatës kriminale ose grupit të strukturuar kriminal.

#### ***A. Historiku i rregullimit normativ mbi bashkëpunimin e posaçëm kriminal***

22. Me miratimin e ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, në ligjin penal material u parashikua si formë e veçantë bashkëpunimi në veprimtarinë kriminale vetëm banda e armatosur dhe organizata kriminale, në nenin 28 të tij.<sup>1</sup> Kjo dispozitë ka ndryshuar fillimisht me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004, i cili ka përfshirë organizatën terroriste dhe grupin e strukturuar kriminal, si forma të veçanta bashkëpunimi kriminal. Ndërsa, me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007, është shfuqizuar paragrafi 2, i pikës 1 dhe është ndryshuar pika 2, e nenit 28 të KP-së, duke mbetur përfundimisht si vijon: “1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet

<sup>1</sup> Kjo dispozitë fillimisht kishte këtë përmbajtje: “Banda e armatosur dhe organizata kriminale përfaqësojnë forma të bashkëpunimit të veçantë që dallohen jo vetëm nga numri i pjesëmarrësve, por edhe nga shkalla e organizimit dhe e qëndrueshmërisë së tyre për kryerjen e një numri veprash penale. Organizata kriminale përfaqëson shkallën më të lartë të bashkëpunimit për kryerjen e veprimtarisë kriminale të qëndrueshme. Krijimi dhe pjesëmarrja në bandë të armatosur dhe në organizata kriminale, si dhe kryerja e veprave penale prej tyre, cilësohen si vepra penale më vete dhe dënohen sipas parashikimeve të Pjesës së Posaçme të këtij Kodi. Pjesëtarët e bandës së armatosur dhe të organizatës kriminale janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera nga banda dhe organizata, kur kanë vepruar si organizatorë, ekzekutorë, shtytës dhe ndihmës. Pjesëtari i bandës së armatosur dhe i organizatës kriminale përjashtohet nga përgjegjësia penale për pjesëmarrjen në to kur pendohet dhe vibet në ndihmë të organeve kompetente për parandalimin e veprimtarisë dhe zbulimin e bashkëpunitorëve. Shërben si rrethanë për zbutjen e dënimit, dhe në raste të veçanta edhe për uljen e tij nën minimumin e parashikuar nga ligji, kur pjesëtari i bandës së armatosur dhe i organizatës kriminale që ka kryer vepra penale, pendohet dhe bashkëpunon me organet kompetente për zbulimin e veprimtarisë dhe bashkëpunitorëve të tjerë. Gjykata, kur çmon se roli i pjesëtarit të penduar të bandës së armatosur dhe të organizatës kriminale nuk është kryesor, kur veprat e kryera prej tij nuk janë me rrezikshmëri të theksuar dhe kur ndihma e dhënë për zbulimin e veprimtarisë dhe bashkëpunitorëve të bandës apo organizatës kriminale është e rëndësishme, mund ta përjashtojë atë nga dënim?”.

nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale. 2. Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste. 3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi. 4. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një vepre penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar. 5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta. 6. Anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale. 7. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose i grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohet vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejt ose jo prej tyre, si dhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale”.

23. Gjithashtu, ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, parashikonte në pjesën e posaçme të tij, neni 333: “Krijimi i bandës së armatosur apo organizatës kriminale ose pjesëmarrja në to, me qëllim për kryerjen e krimeve, dënohet nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.” Kjo dispozitë ka ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 26.9.2004, me përmbajtjen që ka edhe sot (aktualisht në fuqi), titulluar “Organizata kriminale”. Po ky ligj shtoi në KP edhe nenin 333/a, sot në fuqi, si vijon: “Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet. Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet”. Ndërkaq, edhe neni 334, është një dispozitë që është parashikuar që me hyrjen në fuqi të KP-së në vitin 1995. Me ndryshimet e fundit me ligjin nr. 9275, datë 26.9.2004, neni 334 i KP-së, aktualisht parashikon: “1. Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimit për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjobën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim. 2. Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm, dënohet me njëzet e pesë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm. 3. Kur dispozita përkatëse referuese përmban vetëm dënim me burgim të përjetshëm, dënohet me burgim të përjetshëm”.

24. Që në versionin e parë origjinal të KP-së të vitit 1995, krimi i organizuar është konsideruar si një nga format e bashkëpunimit të kryerjes së krimit dhe është renditur në kapitullin IV të KP-së (bashkëpunimi i personave për kryerjen e veprës penale) dhe nuk ka ndryshuar pozicion edhe pas ndryshimeve të vitit 2004 dhe 2007 që i janë bërë nenit 28 të KP-së (“Krimi i organizuar”). Në vitin 1995 vihet re një qasje shumë e përgjithshme ndaj përcaktimit të krimit të organizuar dhe neni 28 bën vetëm dy kategorizime të formave të manifestimit të tij në “bandë të armatosur” dhe “organizatë kriminale”, sikurse është referuar më sipër. Sipas KP-së të vitit 1995, që në këtë aspekt nuk ka pësuar ndryshim edhe sot, format e bashkëpunimit në kryerjen e krimit ndahen në: a) forma të përgjithshme (nenet 25–27); dhe b) forma të veçanta, ku përfshihet banda e armatosur dhe organizata kriminale. Veçantia e këtyre dy formave të krimit të organizuar dallonte nga bashkëpunimi i përgjithshëm i formave të tjera të kryerjes së krimit nga 4 elemente të cilat ishin: 1) numri i pjesëmarrësve; 2) shkalla e organizimit; 3) qëndrueshmëria; dhe 4) kryerja e një numri veprash penale së bashku. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në jurisprudencën e tij vazhdimisht ka arsyetuar që, kur provohet se bashkëpunimi nuk ka qenë rastësor dhe ka tejkaluar marrëveshjen e thjeshtë, duke arritur kështu në një nivel organizimi strukturor që shkon në ngritjen e strukturave vendimmarrëse dhe ekzekutuese në nivel hierarkik, kjo është e mjaftueshme për të konkluduar për ekzistencën në parim të bashkëpunimit të veçantë (*shih vendimin nr. 00-2014-1935 (175), datë 16.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

25. Ndryshimi më i rëndësishëm ligjor në lidhje me nenin 28 vjen me ligjin nr. 7895, datë 16.9.2004. Ky amendim i këtij neni reflekton ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të

Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000 dhe 3 protokollet e saj shoqëruese, e cila u ratifikua nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002.<sup>2</sup> Meqë në shkronjën “a” dhe “c” të nenit 2 të kësaj Konvente jepet përkufizimi i formave të posaçme të bashkëpunimit penal, në nenin 5, nën titullin “*Penalizimi i pjesëmarrjes në një grup kriminal të organizuar*”, parashikohet se çdo shtet palë duhet të adaptojë masa të tilla ligjore dhe masa të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme për të cilësuar si vepra penale, në rastet kur kryhen qëllimisht: a) secilin ose të dy prej rasteve të mëposhtme si vepra penale të dallueshme nga ato që përfshijnë tentativën ose kryerjen e aktivitetit kriminal: (i) marrëveshjen me një ose disa persona të tjerë për të kryer një krim serioz për një qëllim që lidhet direkt ose jodirekt me marrjen e përfitimeve financiare ose materiale dhe, nëse kërkohet nga legjislacioni i brendshëm, që përfshin një veprim të ndërmarrë nga një prej pjesëmarrësve në zbatim të marrëveshjes, ose që përfshin një grup të organizuar kriminal; (ii) veprimin e një personi, i cili, duke njohur qëllimin dhe aktivitetin e përgjithshëm kriminal të një grupi të organizuar kriminal ose synimin e tij për të kryer krimet në fjalë, merr pjesë aktivisht në: Veprimtaritë kriminale të grupit të organizuar kriminal; veprimtaritë e tjera kriminale të grupit të organizuar kriminal, duke ditur se pjesëmarrja e tij/saj do të kontribuojë në arritjen e qëllimit kriminal të përshkruar më lart; b) organizimin, drejtimin, dhënien e ndihmës, përkrahjen, lehtësimin ose dhënien e këshillave për kryerjen e një krimi serioz që përfshin një grup kriminal të organizuar. Më tej, në pikën 3 të kësaj dispozite, parashikohet se shtetet palë, ligji i brendshëm i të cilëve kërkon përfshirjen e një grupi kriminal të organizuar për qëllimet e veprave penale të cilësuar si të tilla, në përputhje me paragrafin 1 (a) (i) të këtij neni, do të sigurojë që legjislacioni i tyre i brendshëm të mbulojë të gjitha krimet serioze që përfshijnë grupet e organizuara kriminale.

26. Duke pasur parasysh edhe detyrimet ndërkombëtare të marra përsipër sikurse u sollën në vëmendje më lart, në amendimet e vitit 2004 të nenit 28 konstatohet se kategorisë së formës së veçantë të krimit të organizuar i bëhet një ndarje më e strukturuar. Kështu, brenda kategorisë së “formës së veçantë të bashkëpunimit”, si edhe në vitin 1995, “organizata kriminale” konsiderohet si forma më e lartë e bashkëpunimit në kryerjen e krimit. Shkalla më e lartë e organizimit të kësaj forme bashkëpunimi do të specifikohet më mirë se ajo në ligjin e vitit 1995, duke e përcaktuar kësaj here shprehimisht në dy kritere të rëndësishme: 1) numrin e pjesëmarrësve (tre ose më shumë persona); dhe 2) qëllimin e kryerjes së aktivitetit kriminal të organizatës, i cili nuk duhet të kishte qëllim ideologjik, por përfitime materiale dhe jomateriale. Në ndryshimet e vitit 2004 shtohet edhe një formë tjetër e organizatës kriminale, “organizata terroriste”. Kjo e fundit, në ndryshim nga organizata kriminale e cila kryen krime për qëllime fitimprurëse materiale dhe jomateriale, ka motiv terrorin, i cili, sipas versionit të nenit 28 të vitit 2004, ka qëllime të karakterit politik (përmbyse të rendit kushtetues, turbullim të rëndë të rendit publik, ngjallje të frikës dhe të pasigurisë në masë). Një ndryshim tjetër i rëndësishëm i vitit 2004, i cili ka mbetur i pandryshuar edhe në KP-në aktual, është përfshirja e disa veçorive përshkruese të organizatës kriminale të ngjashme me ato në KP italian. Por veçoritë e “organizatës kriminale” që përshkruan KP-në shqiptar janë veçori që KP italian i përdor për “organizatat kriminale mafioze” në nenin 416, i cili është kryesisht për aktivitetet e paligjshme ekonomike të organizatës kriminale e cila përdor dhunën dhe “Kodin e heshtjes”.

27. Referuar ndryshimeve të vitit 2004 si më sipër është cituar dhe versioni aktual i KP-së, në ndryshim nga varianti origjinal i nenit 28 të vitit 1995, “banda e armatosur” njësohet si kategori me një strukturë të re organizative siç është “Grupi i strukturuar kriminal”. Të dyja këto grupe kriminale konsiderohen si forma të veçanta bashkëpunimi dhe ndryshimi thelbësor midis tyre është se “banda e armatosur” dallon nga “grupi i strukturuar kriminal” nga përdorimi i mjeteve luftarake për të kryer krime kundër pavarësisë së rendit kushtetues; krimet që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera si dhe aktet terroriste (Pjesa e Posaçme, kërret V, VI dhe VII), (shih vendimin nr. 48, datë 24.2.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë). Në interpretimet e saj gjykata ka bërë një dallim të qartë midis “organizatës kriminale”, “grupit të strukturuar kriminal” dhe “bandës së armatosur”. Në vendimin nr. 48, datë, 24.2.2014, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e nënvizon këtë dallim si të rëndësishëm duke cilësuar: “[...] Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi, pra është një formë më vete bashkëpunimi, e ndryshme nga organizata kriminale, organizata terroriste dhe

<sup>2</sup> Shih ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, “Për ratifikimin e ‘Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar’ dhe dy protokolleve shtesë të saj”.

*grupi i strukturuar. Kjo do të thotë se në rast se ndodhemi para një bande të armatosur, nuk mund të ndodhemi njëkohësisht edhe para bashkëpunimit të thjeshtë ose para organizatës kriminale, sepse këto janë forma të ndryshme bashkëpunimi dhe përjashtojnë njëra-tjetrën.”*

### **B. Legjislacioni dhe standardet gjyqësore ndërkombëtare**

28. Raporti ndërmjet pjesëmarrjes në një organizatë kriminale/grup të strukturuar kriminal dhe kryerjes së veprave në kuadër të saj/tij, përbën një nga çështjet më komplekse në fushën e së drejtës penale edhe në të drejtën evropiane e më gjerë, duke nxitur debate të gjera teorike dhe qasje të ndryshme ligjore në juridiksione të ndryshme. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë trajtuar konceptin e “konkurrimit të veprave penale” kur një person shkel më shumë se një herë ligjin penal, si dhe në konceptin e ndryshëm të “konkurrimit të normave penale”. Në këtë rastin e fundit, në pamje të parë (*prima facie*), një veprim a mosveprim që përbën vepër penale, duket sikur klasifikohet dhe përfshihet nën fushën e zbatimit të më shumë se një norme penale inkriminuese (norma që parashikon vepër penale), por që në fakt, vetëm një është norma penale që do të gjejë zbatim. Për këtë arsye, konkurrimi quhet vetëm në dukje, pra, në aparençë dhe është i ndryshëm nga konkurrimi real. Kjo për shkakun se, në thelb, është i “njëjti fakt”, është e njëjta shkelje dhe cenohet vetëm njëherë e njëjta marrëdhënie juridike. Për të sqaruar nëse ka konflikt në dukje të normave penale apo konkurrim real veprash penale, rëndësi ka të përcaktohet se cilat janë kriteret dhe parimet që shërbejnë për cilësimin e saktë ligjor të normës penale të zbatueshme në rastin konkret dhe mënyrën si veprojnë këto kriteret (*shih vendimin unifikues nr. 3/2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Në këtë vendim njësuës, Kolegjet e Bashkuara, duke u mbështetur edhe në trajtimet doktrinare, kanë theksuar se në rastin e konkurrimit aparent (në dukje) të normave penale, për shkak se kemi të bëjmë me një shkelje të vetme, zbatohet vetëm një normë penale. Ndërsa, në rast të konkurrimit efektiv (real) të veprave penale, kemi bashkim veprash penale dhe rëndim të masës së dënimit, pasi kemi të bëjmë me më shumë se një shkelje të normës që përbën vepër penale. **Teoria e “konkurrimit real”** mbështet idenë se veprat penale të kryera nga anëtarët e një grupi të strukturuar kriminal apo organizatës kriminale janë të pavarura nga pjesëmarrja në grup dhe duhet të trajtohen si veprime të veçanta. Kjo teori nënvizon se çdo akt i kryer është një krim i veçantë dhe duhet ndëshkuar si i tillë. Referuar figurave qendrore në të drejtën penale gjermane, si ndër mbështetësit kryesorë të kësaj teorie<sup>3</sup>, theksohet rëndësia e përgjegjësisë individuale për çdo akt të veçantë kriminal. Një vështrim tjetër doktrinar<sup>4</sup> sugjeron se ndarja e përgjegjësisë për çdo krim të kryer është thelbësore për të siguruar drejtësi.

29. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se pjesëmarrja në një organizatë kriminale/grup të strukturuar kriminal dhe kryerja e veprave konkrete përbëjnë veprime të ndryshme që ndëshkohen veçmas. Praktika gjyqësore shqiptare (një pjesë e konsoliduar e saj) ka pranuar se, veprat penale “Organizata kriminale” dhe “Grup i strukturuar kriminal” janë secila një vepër penale formale, që nënkupton se i pandehuri dënohet për kryerjen e këtyre veprave penale, pavarësisht nëse kryen apo jo ndonjë vepër penale konkrete, në funksion të organizatës kriminale apo të grupit të strukturuar. Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit për këtë fakt penal (krijim apo pjesëmarrje në organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal) duhet saktësuar momenti kur fillon kjo vepër penale, duke u dalluar nga momenti kur fillon kryerja e një vepre të caktuar/konkrete (fillimi i aktivitetit kriminal) në kuadrin e organizatës kriminale apo grupit të strukturuar kriminal. Ligji material penal parashikon shprehimisht, që kur pjesëtarët e një organizate kriminale apo grupi të strukturuar, qofshin këta organizatorët apo pjesëmarrës të thjeshtë, kryejnë vepra penale në kuadrin e këtij grupi, në funksion të qëllimit për të cilin ai është krijuar (referuar aktivitetit kriminal), atëherë zbatohen sanksionet e parashikuara në nenin 334 të KP-së. Por, në vlerësimin e Kolegjit kjo nuk mund ta përjashtojë të pandehurin nga përgjegjësia penale për krijimin *apo* organizimin *apo* drejtimin *apo* pjesëmarrjen në një organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal, përderisa vetë ligji penal përcakton secilën nga këto forma të tij, si penalisht të dënueshme. Dënimi për këtë vepër penale lidhet me kohën para se të fillojë aktiviteti kriminal i organizatës apo i grupit, me kryerjen e veprave

<sup>3</sup> Hans-Heinrich Jescheck, The General Principles of International Criminal Law Set Out in Nuremberg, as Mirrored in the ICC Statute, *Journal of International Criminal Justice*, Volume 2, Issue 1, March 2004, pages 38–55, <https://doi.org/10.1093/jicj/2.1.38>

<sup>4</sup> Claus Roxin, (Gerhard Werle, Boris Burghardt, Introductory Note, *Journal of International Criminal Justice*, Volume 9, Issue 1, March 2011, pages 191–205, <https://doi.org/10.1093/jicj/mqq083>)

konkrete për të cilat ky grup i strukturuar është krijuar – pra i përkon fazës para fillimit të aktivitetit të grupit/kur ai krijohet për një qëllim të caktuar kriminal. Në vlerësimin dhe në interpretimin e Kolegjit, është kjo arsyeja që ligjvënësi e ka parashikuar këtë vepër penale më vete<sup>5</sup>.

30. Në mbështetje të këtij arsyetimi, është edhe përcaktimi ligjor i bërë në nenin 28, pika 5, të KP-së, ku parashikohet shprehimisht: “*Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal, cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose dispozitave të tjera penale të veçanta.*” Në vlerësimin e Kolegjit Penal, ligji penal parashikon se dënohen jo vetëm kryerja e veprave penale konkrete, për të cilat zbatohen edhe sanksionet e parashikuara në nenin 334 të KP-së, por edhe vetë krijimi apo pjesëmarrja në një organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal, që janë parashikuar si vepra penale më vete, sipas neneve 333 dhe 333/a i KP-së. Ky parashikim ligjor parashtron diskutimin nëse në këtë rast cenohet parimi *ne bis in idem*/dënimi i një të pandehuri dy herë për të njëjtin fakt. Në arritjen e konkluzioneve në lidhje me këtë konstatim dhe referuar qëndrimeve të ndryshme të mbajtura nga gjykatat e faktit, Kolegji vlerëson me rëndësi trajtimin e këtij parimi në këndvështrim edhe të jurisprudence së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GJEDNJ”) dhe standardeve ndërkombëtare (duke pasur në konsideratë edhe legjislacionin apo praktikën e gjykatave të vendeve evropiane).

31. Parimi *ne bis in idem* është parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i KP-së dhe neni 7 i KPP-së. Gjithashtu, këtë parim e gjejmë të sanksionuar edhe në disa instrumente ndërkombëtare të ratifikuara edhe nga vendi ynë, ku mund të përmendim: neni 4 i protokollit nr. 7 i Konventës Evropiane të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në vijim “KEDNJ”); neni 35 i Konventës së Këshillit të Evropës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”; neni 53 i Konventës Evropiane “Mbi vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale”. Parimi *ne bis in idem* është i zbatueshëm në dy aspekte të tij që janë: *aspekti procedural* i ndalimit të gjykimit për të njëjtin fakt ndaj një personi i cili është proceduar një herë më parë (neni 7 i KPP-së); *aspekti material* i ndalimit të dënimit dy herë i të njëjtit person për të njëjtin fakt për të cilin ai është dënuar një herë më parë, me vendim përfundimtar (neni 6 i KP-së). GJEDNJ-ja ka trajtuar disa raste që lidhen me parimin *ne bis in idem*, i cili është përkufizuar në nenin 4 të protokollit nr. 7 të KEDNJ-së. Në çështjen Serguei Zolotukhin kundër Rusisë<sup>6</sup>, GJEDNJ-ja ka theksuar se, interpretimi i nenit 4 protokollit nr. 7 ndalon procedimin apo gjykimin e një personi për një “vepër” të dytë, përderisa në origjinë të saj qëndrojnë fakte identike ose në thelb të njëjta me ato të së parës. Duke interpretuar “faktin e njëjtë”, GJEDNJ-ja në këtë vendim konkludon se, janë faktet që përbëjnë një tërësi rrethanash faktike konkrete që implikojnë të njëjtin person dhe që lidhen midis tyre në mënyrë të pazgjidhshme në kohë dhe në hapësirë.

32. Në rastin Zolotukhin kundër Rusisë, GJEDNJ-ja ka analizuar edhe ndryshimet që ekzistojnë mes termave “të njëjta akte apo fakte” nga njëra anë dhe nocionit “e njëjta shkelje apo vepër” nga ana tjetër (ky parashtrim ka rëndësi edhe për analizën në vijim që lidhet me faktin penal të atribuuar të pandehurve në këtë proces penal dhe pyetjet e shtruara për njësim). Në interpretimin e këtyre nocioneve, GJEDNJ-ja është mbështetur edhe në jurisprudence të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (në vijim “GJED”), si dhe të Gjykatës Interamerikane të të Drejtave të Njeriut, të cilët janë bazuar në identitetin e aktit/veprimit material të kryer dhe kanë hedhur poshtë klasifikimin apo kualifikimin ligjor të këtij akti/veprimi, si të parëndësishëm. GJEDNJ-ja ka theksuar se ndalimi i procedimit apo i gjykimit dy herë të një individi, lidhet me të njëjtat fakte kriminale dhe jo me cilësimin ligjor të shkeljes së kryer. Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka pohuar se, fjala “vepër” e parashikuar në nenin 4 të protokollit 7 të Konventës, duhet interpretuar në mënyrë që të mbrojë efektivisht të drejtën e garantuar prej saj, në kushtet aktuale të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore. Në këto kushte, në interpretim të nenit 4 i protokollit 7 është arritur në konkluzionin se, kjo dispozitë garanton ndalimin e një procedimi ose gjykimi të dytë për të njëjtin “shkelje/vepër”, duke nënkuptuar faktet e njëjta mbi të cilat ajo bazohet ose faktet që substancialisht

<sup>5</sup> Në referim të këtij konkluzioni, citohet edhe vendimi nr. 200, datë 12/06/2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku, mes të tjerave, është argumentuar, për praktikën tashmë të konsoliduar në lidhje me formën e veçantë të bashkëpunimit: “*Vepra penale e krijimit dhe pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal e parashikuar nga neni 333/a i KP-së, konkurren me veprat e tjera të kryera nga ana e grupit të strukturuar kriminal dhe nuk përthithet nga këto vepra*”.

<sup>6</sup> Vendim i GJEDNJ-së, datë 10.2.2009.

janë të njëjta. Kjo qasje nga GJEDNJ-ja tregon për një interpretim të qëndrueshëm të parimit *ne bis in idem* edhe në kontekstin e krimit të organizuar, duke lejuar dënimin e veprave të veçanta që ndonëse lidhen me të njëjtën strukturë kriminale, trajtohen veçmas për qëllime dënimi.

33. Në vijim, Kolegji citon edhe një rast tjetër të GJEDNJ-së, që në analizë të fakteve ka ngjashmëri me rastin konkret, çështja Ramda kundër Francës, Në këtë rast, kërkuesi, një shtetas algerian, rezultoi se është ekstraduar nga Mbretëria e Bashkuar në Francë, ku është akuzuar në lidhje me një seri sulmesh terroriste në vitin 1995 në Francë. Ai është gjykuar fillimisht duke u dënuar nga një gjykatë penale (tribunal korrektues) në lidhje me akuzat për pjesëmarrjen e tij në një grup që synonte përgatitjen e sulmeve terroriste. Në vijim, nga faktet e çështjes, rezultoi se kërkuesi Ramda është gjykuar dhe dënuar nga një gjykata “assise” (*cour d’assises*) me akuzën e bashkëpunimit për të kryer një sërë krimesh të veçanta si vrasje dhe tentativa për vrasje, krime të kryera në kuadër të grupit kriminal. Kërkuesi është ankuar për një shkelje të parimit *ne bis in idem* për shkak të dënimit të ri penal, pavarësisht se ishte dënuar më parë, me vendim përfundimtar nga gjykatat e zakonshme penale. GJEDNJ-ja, në lidhje me këtë rast, ka mbajtur qëndrimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 4 të protokollit nr. 7, duke konstatuar se kërkuesi nuk ishte ndjekur penalisht ose dënuar në kuadër të procedimit penal për fakte që kishin qenë në thelb të njëjta me ato për të cilat ai kishte qenë i dënuar më parë me vendim përfundimtar. Kolegji vë në dukje se në rastet e trajtuara nga GJEDNJ-ja në raport me parimin e mos dënimit apo mosgjykimit dy herë për të njëjtin fakt, rëndësi merr pikërisht elementi “i njëjti fakt”. Krijimi apo pjesëmarrja në një organizatë kriminale ose grup të strukturuar kriminal janë akte/veprime që parashikohen si penalisht të dënueshme nga ligji penal shqiptar. Sanksioni i parashikuar nga neni 334 i KP-së, në raport me sanksionet e marra si dënim për konsumimin e këtyre veprave penale formale dhe latente, nuk cenon parimin *ne bis in idem* në kuptimin material. Ky qëndrim është konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila është vënë në lëvizje nga gjykatat e posaçme që kanë iniciuar kontrollin incidental të normës, nenit 334 të KP-së, duke argumentuar shfuqizimin e kësaj dispozite specifikisht shprehjen “*duke i shtuar dënimit për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim*”, parashikuar në pikën 1, të këtij neni (*shih, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 42 datë 5.4.2022, në lidhje me kërkesën për shfuqizimin si të pajtueshme me Kushtetutën të shprehjes “duke i shtuar dënimit për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim”, në pikën 1 të nenit 334 të KP-së*).

34. Lidhur me pretendimin e cenimit të parimit të drejtësisë në caktimin e dënimit penal, Gjykata Kushtetuese, në këtë çështje (vendimi 42/2024) ka vlerësuar se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale nga njëra anë, si dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës<sup>7</sup>. Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se KP-ja në nenin 47 të tij, ka përcaktuar se individualizimi i dënimit është përcaktimi ndërmjet një minimumi dhe një maksimumi të ofruar nga KP-ja dhe zbatimi i kësaj mase brenda kufijve të parashikuar në ligj dhe në përshtatje me karakterin dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj, si dhe shkallën e fajësisë, duke pasur parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat në mënyrë më efikase do të ndikojnë në riedukimin e autorit të veprës penale, çka do të thotë përshtatja e dënimit të veprës penale dhe kryerësit të saj. Në këtë kuptim, neni 28, pika 5, i KP-së parashikon se krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si rrethanë e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale dhe dënohen sipas parashikimeve të këtij Kodi ose dispozitave të tjera penale të veçanta. Bazuar në përmbajtjen e dispozitës së kundërshtuar të KP-së, kur pjesëtari i organizatës kriminale ose i grupit të strukturuar kriminal kryen veprën penale, ai dënohet sipas dispozitave penale përkatëse të veprës së kryer, duke i shtuar këtij dënim edhe 5 vjet burgim që nuk përbën dënim fiks për shkak të formës së organizimit si grup i strukturuar kriminal. Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se KP-ja parashikon për gjyqtarin mundësinë e individualizimit të dënimit për veprën penale të kryer ndaj dhe shtimi i dënimit me 5 vjet i parashikuar nga ky nen nuk cenon thelbin e së drejtës të gjykatës në individualizimin e dënimit për veprën konkrete penale të kryer, duke vendosur se argumentet e gjykatës referuese janë haptazi të pabazuara.

<sup>7</sup> Shih vendimin nr. 47, datë 27.6.2012, të Gjykatës Kushtetuese.

34.1 Ndërkaq, ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtin fakt që përbën veprë penale për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri “e njëjta veprë” i referohet të njëjtut veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj veprë dhe për të cilin personi është dënuar ose liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm<sup>8</sup>. Sa i përket parimit të sigurisë juridike në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese është shprehur se ky parim, si element i shtetit të së drejtës nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ai ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme<sup>9</sup>. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim<sup>10</sup>. Kur i pandehuri kryen veprë penale në rrethanën cilësuese të bashkëpunimit në formën e krimit të organizuar apo pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, dënimi i tij sipas parashikimeve të neneve të posaçme të veprave penale dhe 334 të KP-së, nuk cenon parimin *ne bis in idem*, sipas vlerësimit eksplicit të Gjykatës Kushtetuese. Në këto lloj rastesh, zbatimi i nenit 334 të KP-së shton masën e dënimit të parashikuar nga ligji për veprën penale të kryer për shkak të rrethanës cilësuese së pjesëmarrjes në krim të organizuar. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se në këtë kuptim, neni 334 i KP-së nuk zbatohet veçmas dhe nuk është autonom, por ai shoqëron atë dispozitë penale të veprës konkrete penale të kryer dhe e cilëson veprën penale si të kryer nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal.

35. Në një vështrim krahasues, Kolegji verifikoi edhe legjislacionet e disa prej shteteve evropiane, ku konstatohet fakti se legjislacioni penal parashikon në dispozita të veçanta çështjen e pjesëmarrjes apo krijimit, drejtimit, organizimit të organizatave kriminale dhe grupit të strukturuar kriminal, si dhe dënimin e veprave penale të kryera në kuadrin e këtyre organizatave. Në Gjermani, neni §129 i KP-së (Strafgesetzbuch - StGB) ndalon krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale. Pjesëmarrja dhe krijimi i një grupi të tillë përbëjnë një veprë penale të veçantë. Nëse anëtarët e një grupi kriminal kryejnë veprime të tjera kriminale si pjesë e aktiviteteve të grupit, këto vepra mund të ndëshkohen veçmas. Kështu, pjesëmarrja në një organizatë kriminale dhe kryerja e krimeve brenda saj përbëjnë vepra të ndara penale dhe ndëshkohen të dyja. Në Francë, KP-ja francez (Code Pénal), në nenet 421-1 dhe 450-1, përfshin dispozita që ndalojnë formimin dhe pjesëmarrjen në një grup të strukturuar kriminal (*association de malfaiteurs*). Ashtu si në Gjermani, këto dispozita trajtojnë pjesëmarrjen në grupin kriminal si një veprë të veçantë penale, e cila mund të ndëshkohet pavarësisht nga krimet e tjera të kryera nga anëtarët e grupit. Krimet e kryera në kuadrin e pjesëmarrjes në këtë grup mund të ndëshkohen gjithashtu veçmas. KP italian (Codice Penale) përfshin dispozita specifike që ndalojnë krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, sipas nenit 416-bis. Pjesëmarrja në një grup të tillë përbën një veprë penale më vete dhe krimet e kryera nga ky grup mund të ndëshkohen veçmas. Në Spanjë, KP-ja (Código Penal) përfshin dispozita që ndalojnë krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, të parashikuar në nenin 570-bis. Si në vendet e tjera, pjesëmarrja dhe krijimi i një organizate të tillë janë vepra penale të veçanta. Krimet e kryera në kuadrin e organizatës kriminale ndëshkohen gjithashtu veçmas, duke u trajtuar si vepra të ndara. Në Mbretërinë e Bashkuar, ligji penal përfshin ndalimin e pjesëmarrjes në një organizatë kriminale përmes dispozitave të shumta, përfshirë Aktin e Krimit të Organizuar dhe Policisë së Krimit të Rëndë (Serious Crime Act 2007). Si në vendet e tjera, pjesëmarrja në një organizatë kriminale është një veprë penale më vete dhe ndëshkohet veçmas nga krimet specifike të kryera nga organizata. Në Holandë, KP-ja (Wetboek van Strafrecht) përmban dispozita që parashikojnë ndëshkimin e pjesëmarrjes në organizata kriminale (neni 140). Ky nen përcakton që pjesëmarrja në një organizatë të tillë është një veprë penale më vete dhe mund të ndëshkohet pavarësisht nëse individi është dënuar për veprime të tjera kriminale të kryera në kuadrin e organizatës. Në Greqi, legjislacioni penal ndëshkon pjesëmarrjen në organizata

<sup>8</sup> Shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 33, datë 22.7.2011; nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>9</sup> Shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>10</sup> Shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 41, datë 6.7.2016; nr. 21, datë 16.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

kriminale, ku sipas nenit 187 të KP-së, pjesëmarrja në një organizatë kriminale është një veprë penale e pavarur nga çdo veprë specifike e kryer brenda organizatës. Dënimet për pjesëmarrje në një organizatë kriminale janë të ndara nga ato për veprat penale të kryera nga individët si pjesë e organizatës. I njëjti parim ka përparësi apo mbizotëron edhe në legjislacionin e Suedisë<sup>11</sup> dhe Polonisë<sup>12</sup>, pa përjashtuar vendet e tjera evropiane.

36. Në të gjitha këto shtete, legjislacioni penal trajton pjesëmarrjen apo krijimin e organizatave kriminale/grup i strukturuar kriminal si vepra penale të ndara nga veprat që mund të kryhen në kuadrin e pjesëmarrjes në këto organizata. Kjo do të thotë se një individ mund të ndëshkohet për pjesëmarrjen në një organizatë kriminale ose në grup të strukturuar kriminal, por njëkohësisht ai dënohet edhe për veprat specifike të kryera nga kjo organizatë. Në këtë mënyrë, ligjet në këto shtete evropiane lejojnë që të ndëshkohen të dyja veprat në mënyrë të pavarur duke i dhënë rëndësi të veçantë luftës kundër kriminalitetit të organizuar. Kolegji vëren se ashtu siç parashikohet në legjislacionin penal shqiptar, edhe sipas këtyre legjislacioneve, dënimi për pjesëmarrje në një organizatë kriminale/grup të strukturuar kriminal mund të ndodhë edhe pa u dënuar për veprat penale specifike të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në këtë organizatë apo grup të strukturuar kriminal. Kjo do të thotë që pjesëmarrja në organizatën kriminale dhe kryerja e veprave konkrete trajtohen si veprime të pavarura dhe ndëshkohen si të tilla. Pjesëmarrja në një organizatë kriminale mund të përfshijë një gamë të gjerë aktiviteteve që kontribuojnë në funksionimin ose mbështetjen e organizatës, pa përfshirë domosdoshmërisht kryerjen e një veprë penale konkrete nga ana e pjesëmarrësit.

37. Në thelb, Kolegji vlerëson se krijimi *apo* organizimi *apo* drejtimi *apo* pjesëmarrja, pra vetë ekzistenca e një organizate kriminale/grupi të strukturuar kriminal paraqet rrezikshmëri dhe vë në rrezik rendin publik, pavarësisht nëse janë kryer apo jo vepra penale në kuadër të kësaj organizate apo grupi kriminal. Edhe më lart është theksuar se, nenet 333 dhe 333/a të KP-së janë vepra penale formale, përmes të cilëve ligjvënësi ka parashikuar si penalisht të dënueshme edhe vetëm krijimin apo pjesëmarrjen në një organizatë kriminale ose grup të strukturuar kriminal. Nga ana tjetër, kur anëtarët e një organizate kriminale apo grupi të strukturuar kriminal në përmbushje të qëllimit për të cilin ato janë organizuar, kryerjen edhe vepra të ndryshme penale, ligji penal parashikon shtimin e dënimit pikërisht për këtë fakt, sanksionuar në nenin 334 të KP-së.

### ***C. Analiza e ligjit penal shqiptar në raport me Grupin e Strukturuar Kriminal dhe Organizatën Kriminale***

38. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (KBGJL) në vendimin unifikues nr. 4, datë 15.7.2011, kanë identifikuar se kur një fakt penal do të cilësohet i kryer në bashkëpunim, duke theksuar se duhet të verifikohet ekzistenca e katër kushteve *sine qua non*: 1) *dy ose më shumë persona*; 2) *realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale*; 3) *dhënia e një kontributi i cili ka lidhje me kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve*, si dhe nga pikëpamja subjektive 4) *dijenja e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e veprës penale*. Praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrimin se mungesa e njërit prej 4 elementeve rrëzon ekzistencën e “bashkëpunimit” dhe në këtë qëndrim Kolegjet Penale të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë kanë qenë konstante dhe kanë arsyetuar ngushtësisht të provuarit e “bashkëpunëtorëve” dhe “kontributit” të tyre në marrëveshje.

39. Në nenin 28 të KP-së, në paragrafin 4 të tij, jepet kuptimi i grupit të strukturuar kriminal, duke përcaktuar elementet e veçantë që e dallojnë këtë formë të posaçme nga bashkëpunimi i thjeshtë. Ky përkufizim është në unison me sa parashikon Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar, e ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002: “*Grup i strukturuar*” nënkupton një grup që nuk është formuar në mënyrë të rastësishme për kryerjen e menjëhershme të një veprë penale dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësimit në të ose të ketë një strukturë të zhvilluar”. Në këtë kuptim, praktika gjyqësore ka verifikuar ekzistencën e elementeve të grupit të strukturuar kriminal: a) numri i pjesëmarrësve, të paktën tre ose më shumë personave, bashkëpunim i cili bëhet me qëllim kryerjen e një ose disa veprave penale. b) Ky grup i strukturuar kriminal nuk formohet rastësisht. Kjo do

<sup>11</sup> Kodi Penal suedez (Brottsbalken).

<sup>12</sup> Kodi Penal polak (Kodeks Karny).

të thotë se, për të qenë para kësaj forme të bashkëpunimit të veçantë, kërkohet që ky bashkëpunim të ketë ekzistuar, paraprakisht, që para se të fillojë kryerja e veprës penale, të ekzistojë edhe në momentin e fillimit të kryerjes së veprës penale si dhe gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprës penale. Pra, ky bashkëpunim duhet të jetë i planifikuar dhe i paramenduar, që para se të fillojë kryerja e veprës penale nga të paktën një prej bashkëpunëtorëve. c) Grupi i strukturuar kriminal ka një strukturë dhe organizim të caktuar, edhe minimale. Ky element i grupit të strukturuar kriminal, rezulton nga përmbajtja e fjalisë së dytë të paragrafit 4 të nenit 28 të KP-së, i cili përcakton se grupi i strukturuar nuk është e nevojshme të dallohet për një organizim dhe strukturim të zhvilluar. Pra, ligji penal pranon se kjo formë e veçantë bashkëpunimi ka një lloj organizimi dhe strukturimi minimal (nuk është në nivel të zhvilluar). Pasja e një strukture dhe organizimi minimal për kryerjen e veprës penale, në këtë formë të veçantë bashkëpunimi e dallon atë nga bashkëpunimi i thjeshtë. ç) Grupi i strukturuar kriminal, si formë e veçantë bashkëpunimi, duke qenë se kërkon një organizim dhe strukturim të caktuar minimal, nënkupton që midis anëtarëve të grupit, të ekzistojë një ndarje minimale edhe e detyrave, që bëhet për të arritur qëllimin e përbashkët për të cilin ato kanë rënë dakord – kryerjen e veprës apo veprave penale.

40. Neni 28, paragrafi i katërt i KP-së, thekson pikërisht këtë se grupi i strukturuar kriminal “*nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar*”. Kolegji thekson se, në rastet kur verifikohet një anëtarësi e qëndrueshme, ndarje e detyrave ku secili e ka qartë rolin e tij, ku ekziston gjithmonë një drejtues dhe një ose disa persona të tjerë që zbatojnë urdhrat e tij, kjo është karakteristikë e organizatës kriminale, si forma më e lartë e bashkëpunimit të veçantë. Në rastin e grupit të strukturuar kriminal është e domosdoshme që të ekzistojë gjithmonë një ndarje minimale detyrash, në kuptimin që mund dhe duhet të ketë një organizator, si dhe një ose disa persona të tjerë që të veprojnë si ekzekutorë, shtytës apo ndihmës. Kolegji vëren se, edhe në verifikimin e ekzistencës së organizatës kriminale sipas ndryshimeve të vitit 2017, gjykatat kanë ndjekur të njëjtën logjikë të interpretimit të veçorive të kësaj forme bashkëpunimi të veçantë sipas së cilës duhet që të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 28 për organizatën kriminale të jenë të provuara njëkohësisht. Në praktikën e tij, Kolegji Penal e ka veçuar organizatën kriminale nga grupi i strukturuar kriminal vetëm nga qëndrueshmëria e lidhjes midis anëtarëve të grupimit kriminal, i cili organizohet për të kryer një numër të papërcaktuar veprash penale, pa përcaktuar në mënyrë shteruese konceptin “lidhje e qëndrueshme”<sup>13</sup>, por mjaftohet duke cilësuar se qëndrueshmëria duhet të vazhdojë edhe pas kryerjes së një apo disa veprave penale.

41. Në lidhje me nenin 334 të KP-së, në radhë të parë Kolegji vë në dukje se kjo dispozitë nuk përfshin të gjitha format e bashkëpunimit të posaçëm penal. Nga leximi i nenit 334 të KP-së në lidhje me nenin 28 të tij, del se vetëm kryerja e veprave penale në kuadër të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal, mundet të legjitimojë gjykatën e posaçme të zbatojë shtesën e dënimit me burgim, sipas rasteve të parashikuara në këtë dispozitë. Ndërkohë që nuk ka një limit maksimum të shtesës së gjobës me një të tretën e masës së caktuar të saj si dënim penal për një vepër penale konkrete, dispozita parashikon për dënimin me burgim se shtesa e dënimit nuk duhet të kalojë maksimumin e dënimit me burgim. Kjo dispozitë parashikon shtesën e një dënimi të caktuar duke u përshkallëzuar kjo shtesë në varësi të dispozitës penale konkrete për të cilën pjesëtari i një grupi të strukturuar kriminal apo organizatës kriminale, gjendet fajtor. Konkretisht, shtesa e dënimit në përgjithësi është me pesë vjet burgim apo me një të tretën shtesë të masës së caktuar të gjobës. Ndërsa, kur dispozita penale konkrete parashikon dënimin me burgim apo burgim të përjetshëm, i pandehuri duhet dënuar me 25 vjet burgim ose burgim të përjetshëm; kur dispozita penale parashikon vetëm dënimin, edhe dënimin që do të caktohet është pikërisht burgimi i përjetshëm.

42. Ligji material penal parashikon shprehimisht që kur pjesëtarët e një grupi të strukturuar, qofshin këta organizatorët apo pjesëmarrës të thjeshtë, kryejnë vepra penale në kuadrin e këtij grupi – në funksion të qëllimit për të cilin ai është krijuar, atëherë zbatohen sanksionet e parashikuara në nenin 334 të KP-së.

<sup>13</sup> Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 175, datë 16.7.2014, sipas të cilit: “*Ndryshimi midis organizatës kriminale si formë e bashkëpunimit të qëndrueshëm dhe bashkëpunimit të thjeshtë qëndron në faktin se në rastin e organizatës kriminale kërkohet një lidhje e qëndrueshme mes anëtarëve të organizatës të cilët janë organizuar me qëllim kryerjen e një numri të papërcaktuar veprash penale. Në rastin e bashkëpunimit, dy ose më shumë persona kryejnë së bashku një ose disa vepra penale; lidhja mes bashkëpunëtorëve ka një qëllim të caktuar, e cila lidhet me kryerjen e disa veprave penale të programuara, konsumimi i të cilave do t'i sjellë fundin edhe bashkëpunimit mes bashkëpunëtorëve.*”

Sanksioni i parashikuar në nenin 334 të KP-së, tregon shkallën më të lartë të rrezikshmërisë së një veprë penale konkrete, kur ajo kryhet në një formë të cilësuar/të veçantë bashkëpunimi. Praktika gjyqësore dominuese ka pranuar se në raste të tilla, të pandehurit janë cilësuar fajtorë për dispozitën penale konkrete referuar faktit penal, por pa u cilësuar kjo dispozitë sipas rrethanës së bashkëpunimit, në rastin kur neni e parashikon një rrethanë të tillë cilësuese. Kjo pasi në këtë rast, vepra është verifikuar e kryer në një formë të veçantë bashkëpunimi (pra jo në bashkëpunim të thjeshtë siç parashikohet në shumë prej dispozitave penale konkrete), e si rrjedhojë do të zbatohet sanksioni/dënim i përcaktuar në nenin 334 të KP-së. Një interpretim i ndryshëm do të cenonte parimin “*ne bis in idem*”, pasi i pandehuri do të dënohej për rrethanën e cilësuar të bashkëpunimit, edhe sipas parashikimit që bën dispozita penale konkrete – në rastin konkret neni 284, paragrafi i dytë i KP-së, por edhe për rrethanën e bashkëpunimit të posaçëm sipas nenit 334 të këtij Kodi. Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson të drejtë qëndrimin e mbajtur nga gjykata e shkallës së parë, e cila për të shmangur dënimin dy herë të të gjykuarve në këtë proces penal për rrethanën e ‘bashkëpunimit’, i ka deklaruar ata fajtorë për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, sipas paragrafit të parë të nenit 284 të KP-së, duke i shtuar sanksionin e parashikuar në paragrafin e parë të nenit 334 të këtij Kodi, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.

43. Kolegji vlerëson se për të dhënë një qëndrim të njësuar duhet të ndalemi në analizën e natyrës së nenit 334 të KP-së. Ky nen nuk përmban vepër penale të veçantë, si një veprim apo mosveprim shoqëror, individual apo në grup, që passjell ngarkimin me përgjegjësi penale. Pra, kjo dispozitë, ndonëse është vendosur në pjesën e posaçme të KP-së, nuk është një normë tipike penale që përshkruan një veprim a mosveprim, një shkelje të ligjit që sanksionohet me një dënim. Kodi Penal shqiptar nuk parashikon një përkufizim të nocionit “vepër penale”, por doktrina dhe jurisprudenca ka pranuar se veprat penale parashikojnë një sjellje, veprim apo mosveprim në kundërshtim me ligjin (kundërligjshmëria), që kryhet me faj (në format përkatëse të fajit) dhe ka si pasojë një sanksion/dënim (dënueshmëria). Nga një interpretim semantik i përmbajtjes së nenit 334 të KP-së nuk del se kjo dispozitë përmban përshkrim të ndonjë sjellje apo veprimi/mosveprimi të kundërligjshëm si pjesë të saj. Kjo dispozitë jo vetëm nuk përshkruan elemente konkrete të një figure të veçantë veprë penale, por referon në dispozita të tjera penale, që kryhen nga pjesëtarët e organizatës kriminale apo grupit të strukturuar kriminal. Në këtë dispozitë parashikohet vetëm pjesa e sanksionit, që vjen si rrjedhojë e një rrethane cilësuese, duke referuar në vepra të tjera penale, të kryera në një nga dy format e veçanta të bashkëpunimit, të parashikuara shprehimisht nga ky nen. Ky ndërtim i dispozitës është dukshëm i ndryshëm nga dispozitat penale që përmbajnë vepra penale të posaçme, me të cilët ka të përbashkët vetëm elementin “sanksion”, duke e bërë këtë dispozitë si një normë që rregullon mënyrën e caktimit të dënimit.

44. Drejtimin, organizimin, financimin dhe pjesëmarrjen në organizatën kriminale, organizatën terroriste dhe grupin e strukturuar kriminal, ligjvënësi e ka parashikuar si vepër penale formale dhe latente, duke e dënuar si krim me sanksionet përkatëse (shih nenin 234/a, 234/b, 284/a, 333 dhe 333/a të KP-së). Njëkohësisht, për kryerjen e veprave penale në kuadër të këtyre formave të posaçme të bashkëpunimit, ka parashikuar një shtesë dënim me burgim 5 vjet dhe me gjobë në masën një të tretën, sipas nenit 334 të KP-së. Kjo do të thotë se individ i përgjegjshëm para ligjit penal, që kryen vepër penale si pjesë e organizatës kriminale, organizatës terroriste dhe grupit të strukturuar kriminal, dënohet fillimisht si pjesëtar i këtyre formave të posaçme bashkëpunimi, qoftë për krijimin, drejtimin apo edhe vetëm pjesëmarrjen në to. Ligjvënësi ka parashikuar më tej, se kur pjesëtarët e një organizate kriminale apo grupi të strukturuar kriminal, kryejnë edhe veprat penale për të cilat janë organizuar në këto forma të veçanta bashkëpunimi, do të dënohen sipas dispozitave penale konkrete. Shtesa e dënimit të parashikuar në nenin 334 nuk do të thotë se të pandehurit/të gjykuarit po dënohen dy herë për të njëjtin fakt penal apo rrethanë, referuar bashkëpunimit, pasi në këtë rast të dytë verifikimi i bashkëpunimit lidhet me kryerjen e veprës penale konkrete që tregon një rrezikshmëri më të lartë të autorit të saj, në raport me krijimin apo vetëm pjesëmarrjen në një organizatë kriminale apo grupit të strukturuar kriminal. Siç u theksua edhe më lart, ajo që shmang cenimin e mosdënimit dy herë për të njëjtin fakt është që zbatimi i dispozitës penale konkrete nuk lidhet me rrethanën cilësuese të bashkëpunimit të thjeshtë, që në shumicën e rasteve është pjesë e normës penale.

45. Kolegji, në rrethanat e parashtuara, referuar edhe konkluzioneve të vendimit unifikues nr. 3, datë 2.11.2015, mbi kriteret e konkurrimit dhe përthithjes së veprave penale ndërmjet tyre (cituar më lart), vlerëson se, në funksion të çështjeve të shtrutura për njësim, midis neneve 333, 333/a dhe 334 të KP-së mund të diskutohet vetëm konkurrimi i normave penale (konkurrim aparent/në dukje). Kolegji arrin në këtë konkluzion pasi në konkurrimin e normave penale e njëjta marrëdhënie juridike e mbrojtur, pra e njëjta “lëndë” duket sikur rregullohet, në pamje të parë nga një pluralitet normash. Konkretisht “lënda” është krijimi, organizimi, drejtimi, pjesëmarrja në organizatën kriminale dhe grupin e strukturuar kriminal, si dhe kryerja e veprave penale në kuadrin e këtyre të fundit. Me premisën se me konkurrim “në dukje” të normave penale do të kuptohet dukuria në bazë të së cilës një fakt që përbën vepër penale, në kuptimin e tij si një episod historik, pra një ngjarje historike, duket sikur klasifikohet “njëkohësisht” si shkelje e më shumë se një dispozite ligjore penale, nevojitet analiza dhe interpretimi sistematik dhe literal i neneve 333, 333/a dhe 334 të KP-së, me qëllim shmangien e cenimit të parimit themelor të ndalimit të gjykimit apo dënimit dy herë për të njëjtën fakt/vepër penale (*ne bis in idem*).

46. Referuar parimeve doktrinarë, si dhe jurisprudenciale, konkretisht: i) parimi i specialitetit (*lex specialis derogat legi generali*); ii) parimi i subsidiaritetit (*lex primaria derogat legi subsidiariae*), iii) parimi i përthithjes (*lex consumens derogat legi consumptae*), nuk rezulton që nenet 333, 333/a dhe 334 të KP-së të përjashtojnë njëri-tjetrin nëpërmjet përthithjes në zbatimin njëherësh të tyre, në eventualitetin e kryerjes së veprave penale në kuadër të organizatës kriminale dhe grupit të strukturuar kriminal. Krahasimisht me njëra-tjetrën, dispozitat në këto nene nuk kanë raporte përparësie dhe asnjëra prej tyre nuk duket se përbën normë të posaçme në raport me tjetrën. Asnjë prej këtyre dispozitave nuk përmban elementet e plotë të tjetrës, si dhe asnjë prej tyre nuk është nënbashkësi e elementeve të tjetrës. Krijimi, organizimi, drejtimi dhe pjesëmarrja në organizata kriminale dhe grup të strukturuar kriminal nuk përmban *apriori* elementin e kryerjes së veprave nga autori, ndërsa, anasjelltas, kryerja e veprave penale në kuadër të organizatës kriminale dhe grupit të strukturuar kriminal, si rrjedhojë logjike, nënkupton së paku pjesëmarrjen në këto të fundit të autorit. Zbatimi i nenit 334 i KP-së, si një dispozitë që parashikon vetëm sanksion/shtim dënimi, kur verifikohet rrethana e kryerjes së veprës penale nga organizata kriminale apo grupi i strukturuar kriminal (siç zbatohet edhe neni 25 i KP-së në rastet e bashkëpunimit të thjeshtë), nuk mund të konsiderohet normë e posaçme penale që të mund të përthithë në zbatim nenet 333 dhe 333/a të KP-së (dispozita penale këto që parashikojnë si penalisht të dënueshme veprimin e krijimit, organizimit ose drejtimit apo pjesëmarrjes në një organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal). Referuar parimit të subsidiaritetit, Kolegji çmon se ndërmjet normave/nenet 333, 333/a dhe 334 të KP-së nuk ekziston raporti hierarkik, pasi asnjëra prej tyre nuk përbën normë kryesore që të mund të “zhvlerësojë” nevojën e zbatimit të tjetrës, në funksion të zbatimit të parimit të ligjshmërisë. Raporti i ndërveprimit në këtë rast, mund të konsiderohet si një raport autonom, ku njëra normë (neni 333 dhe 333/a) mund të zbatohet më vete, në raport me normën tjetër (nenin 334). Kjo e dyta, zbatohet vetëm kur verifikohet kryerja e një veprë penale konkrete, si një rrethanë që rëndon masën e dënimit, *ipso lege*.

47. Kolegji, nisur nga analiza krahasuese e argumentet sa më sipër u përmendën për natyrën e parashikimeve ligjore të neneve 28, 333, 333/a, 334 të KP-së, vlerëson se në funksion të një interpretimi të njësuar të instituteve penale të bashkëpunimit të veçantë dhe të përgjegjësisë penale të bashkëpunëtorëve në kryerjen e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe të organizatës kriminale, secila dispozitë ndjek një qëllim të caktuar, duke plotësuar njëra tjetrën në penalizimin e bashkëpunimit të veçantë kriminal. Dispozita e përgjithshme e nenit 28 të KP-së ka si qëllim parashikimin e të gjitha formave të bashkëpunimit të veçantë si organizata kriminale, organizata terroriste, banda e armatosur dhe grupi i strukturuar kriminal; ndërsa dispozitat e posaçme, nenet 333, 333/a të KP-së, parashikojnë si vepra penale krijimin, organizimin ose drejtimin apo pjesëmarrjen në organizatën kriminale ose në grupin e strukturuar kriminal. Nga ana tjetër, neni 334 i KP-së, ndonëse është një dispozitë materiale dhe në pjesën e posaçme të KP-së, në raport me nenin 28, paragrafët 5 e 6 të këtij Kodi, nuk është një vepër penale më vete, por një dënim që i shtohet dënimit të caktuar nga gjykata për veprën penale konkrete të kryer nga organizatori apo pjesëmarrësi në një organizatë kriminale ose në një grup të strukturuar kriminal, një dispozitë që ka si qëllim pikërisht mënyrën e caktimit të dënimit për veprat penale të kryera në formën e grupit të strukturuar kriminal e të organizatës kriminale.

48. Zbatimi i nenit 334 të KP-së, në raport me nenet 333 dhe 333/a të këtij Kodi, nuk cenon parimin e mosgjykimit dy herë për të njëjtin fakt penal (sipas nenit 7 të KPP-së), pasi neni 334 i KP-së është një dënim i shtuar vetëm kur pjesëtarët e organizatës kriminale apo grupit të strukturuar kriminal kryejnë një veprë penale konkrete në të tria format e bashkëveprimit si atë para kryerjes së veprës penale “*concursum anteceds*”, në momentin e kryerjes së veprës penale “*concursum consomitans*”, ashtu dhe pas kryerjes së veprës penale “*concursum subsequens*”. Kolegji vlerëson se, veprat penale “Organizatë kriminale” (neni 333 i KP-së) dhe “Grupi i strukturuar kriminal” (neni 333/a i KP-së), kryhen në formën e krijimit, organizmit, drejtimit apo pjesëmarrjes dhe cilësohen nga KP-ja si vepra penale më vete, formale, që ndëshkojnë veprimet *delicta preparata*. Nëpërmjet këtyre rregullimeve, KP-ja ndëshkon jo vetëm kryerjen e veprave penale konkrete në kuadër të një organizate kriminale apo grupi të strukturuar kriminal, por edhe vetë krijimin, organizimin, drejtimin apo pjesëmarrjen në një organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal, duke adaptuar ndëshkimin e dyfishtë, parashikuar si vepra penale më vete, sipas neneve 333 dhe 333/a të KP-së. Neni 334 i KP-së nuk është një dispozitë që zbatohet veçmas (nuk është veprë penale), por është dënimi i shtuar që shoqëron dispozitën penale e cila parashikon figurën e veprës penale konkrete të kryer nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal.

#### **D. Përfundime**

49. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arrin në konkluzionet njëse, si më poshtë vijon:

1) Neni 334, ndonëse është një dispozitë e Kodit Penal, në raport me nenin 28, paragrafët 5 e 6 të këtij Kodi, nuk është një veprë penale më vete, por një dënim që i shtohet dënimit të caktuar nga gjykata për veprën penale konkrete të kryer nga organizatori apo pjesëmarrësi në një organizatë kriminale ose në një grup të strukturuar kriminal.

Veprat penale të parashikuara në nenet 333 dhe 333/a të Kodit Penal janë vepra penale formale, që nënkupton se personi dënohet për kryerjen e këtyre veprave (në formën e krijimit, organizimit, drejtimit apo pjesëmarrjes), pavarësisht nëse kryen apo jo ndonjë veprë penale konkrete.

2) Zbatimi i nenit 334 të Kodit Penal në raport me nenet 333 dhe 333/a të këtij Kodi, nuk cenon parimin e mosgjykimit dy herë për të njëjtin fakt penal (sipas nenit 7 të KPP-së), pasi neni 334 është një dënim i shtuar vetëm kur pjesëtarët e organizatës kriminale apo grupit të strukturuar kriminal kryejnë një veprë penale konkrete.

Veprat penale “Organizatë Kriminale”/“Grupi i strukturuar kriminal” kryhen në formën e krijimit, organizmit, drejtimit apo pjesëmarrjes dhe cilësohen nga Kodi Penal si vepra penale më vete. Kodi Penal ndëshkon jo vetëm kryerjen e veprave penale konkrete në kuadër të një organizate kriminale apo grupi të strukturuar kriminal, por edhe vetë krijimin, organizimin, drejtimin apo pjesëmarrjen në një organizatë kriminale apo grup të strukturuar kriminal, parashikuar si vepra penale më vete, sipas neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal.

3) Neni 334 i Kodit Penal nuk është një dispozitë që zbatohet veçmas (nuk është veprë penale), por është dënimi i shtuar që shoqëron dispozitën penale e cila parashikon figurën e veprës penale konkrete të kryer nga organizata kriminale ose grupi i strukturuar kriminal.

#### **IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete**

50. Mbajtur në konsideratë konkluzionet njëse të arritura si më sipër, ballafaqimin e tyre me rrethanat faktike dhe ligjore të çështjes konkrete në këtë gjykim, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në vendimmarrjen e saj, nuk ka zbatuar drejt ligjin material penal, konkretisht nenet 28/5/6, 333, 333/a, dhe 334 të KP-së, ndaj vendimi nr. 60, datë 12.6.2018, i kësaj gjykate, çmohet prej këtij Kolegji se duhet ndryshuar pjesërisht si i pabazuar në ligj. Ndërsa, sa i përket vendimmarrjes nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Kolegji e çmon atë, të marrë në zbatim të drejtë të ligjit material penal.

51. Kolegji çmon të theksojë se qëllimi dhe nevoja për këtë vendim njëse, në vetvete nuk është domosdoshmëria për shtimin e masës së dënimit sipas përcaktimeve të nenit 334 të KP-së, ndaj të pandehurve të deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 333 dhe 333/a të këtij Kodi, për më tepër (*a fortiori*) për të pandehurit në këtë gjykim, por është njësimi i praktikës gjyqësore në drejtëm të zbatimit të drejtë dhe të njëtrajtshëm të ligjit penal. Prandaj, duke mbajtur në vëmendje sa

më sipër, si dhe mungesën e kohezionit/aktualitetit (*kobën e gjatë të kaluar*), ndërmjet datës (16.3.2018) së vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, deri aktualisht, në shqyrtimin e rekurseve të paraqitura nga të pandehurit dhe marrjen e këtij vendimi njësoje, Kolegji vlerëson për ndryshimin “*in melius*”, lehtësimin e masës së dënimit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë, ndaj secilit prej të pandehurve në këtë gjykim, gjendja juridike e të cilit ndikohet nga kjo sentencë njësoje (*rregull gjyqësor*).

52. Kolegji vlerëson të drejtë konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë, që ka çmuar e vlerësuar provat në harmoni me njëra tjetrën, sipas nenit 152 e 405 e vijues të KPP-së (referuar gjendjes së akteve të fashikullit të hetimeve për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar). Tërësia e provave të marra e të verifikuara në këtë gjykim, provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e secilit prej të gjykuarve në raport me faktin penal të atribuar – kultivimin e bimëve narkotike, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Të dyja gjykatat e faktit, pavarësisht zbatimit të ndryshëm në raport me nenet 333/a dhe 334 të KP-së, kanë pranuar në thelb se është krijuar një grup i strukturuar kriminal me qëllimin për të kultivuar bimë narkotike. Kështu, me të drejtë gjykata e shkallës së parë (pjesërisht edhe gjykata e apelit), në verifikimin e ekzistencës së grupit të strukturuar kriminal, ka analizuar se në secilin nga episodet e analizuara rezulton bashkëveprimi i më shumë se tre personave; rezulton se i gjykuari Lavdim Nelaj është organizatori i gjithë kësaj veprimtarie, me synim kultivimin e paligjshëm të lëndës narkotike kufijve, aktivitet të cilin e kryen me ndihmën e të bashkëgjykuarve të tjerë (fakt ky që është evidentuar në mënyrë të detajuar edhe nga gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e vendimit). E gjithë veprimtaria e përbashkët e të gjykuarve është realizuar kundrejt shpërblimit që merr secili, për pjesën e tij të ndihmës së dhënë. Këto fakte janë analizuar nga gjykata e shkallës së parë, argumentimi i së cilës plotëson standardet e një vendimit gjyqësor të arsyetuar (shkak për të cilin Kolegji e mbështet këtë vendimmarrje). Provat e marra e të shqyrtuara në këtë proces penal kanë provuar se në secilin episod, “suksesi i veprimtarisë së përbashkët”/arritja e qëllimit final, është realizuar falë kontributit/ndihmës që ka dhënë secili nga të bashkëgjykuarit dhe nga personat e tjerë bashkëpunëtorë.

53. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson të drejtë vendimin nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda vetëm për sa ka disponuar për të gjykuarin Bashkim Kodra. Në lidhje me të gjykuarit Lavdim Neziri (Nelaj), Lifter Nelaj, Bledar Baboçi, Hashim Nelaj, Bajram Hidri, të akuzuar për veprat penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 284/1, 28/4, 333/a, 334/1 të KP-së, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatave të faktit duhen ndryshuar pjesërisht, në zbatim të konkluzioneve njësoje të cituara më lart. Në fund, Kolegji vlerësoi se duhet disponuar për prishjen e vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në lidhje me gjykuarit Elton Haxhiu, Sami Balloku, Astrit Tafaj dhe Aldo Xhaferri.

## PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 441, pika 1, shkronjat “b”, “dh” dhe “e”, të Kodit të Procedurës Penale,

## VENDOSI:

**I.** Lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda në lidhje me të gjykuarin Bashkim Kodra.

**II.** Ndryshimin e vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda si më poshtë:

1. - Deklarimin fajtor të të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj) për kryerjen e veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj) për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar

nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 9 (nëntë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Lavdim Neziri (Nelaj) me një dënim të vetëm me 9 (nëntë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së, dënimin e tij përfundimisht, me 6 (gjashtë) vjet burgim.

2. - Deklarimin fajtor të të pandehurit Lefter Nelaj për kryerjen e veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Lefter Nelaj për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 9 (nëntë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Lefter Nelaj me një dënim të vetëm me 9 (nëntë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin e tij përfundimisht, me 6 (gjashtë) vjet burgim.

3. - Deklarimin fajtor të të pandehurit Bledar Baboçi (ndryshe Noka ose Trokthi) për kryerjen e veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Bledar Baboçi (ndryshe Noka ose Trokthi) për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Bledar Baboçi (ndryshe Noka ose Trokthi) me një dënim të vetëm me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së e tij përfundimisht me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

4. - Deklarimin fajtor të të pandehurit Hashim Nelaj për kryerjen e veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Hashim Nelaj për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike” të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Hashim Nelaj me një dënim të vetëm me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin e tij përfundimisht me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

5. - Deklarimin fajtor të të pandehurit Bajram Hidri për kryerjen e veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Bajram Hidri për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 28/4, 284/1 të KP-së dhe në bazë edhe të nenit 334/1 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/1 të KP-së, dënimin e të pandehurit Bajram Hidri me një dënim të vetëm me 8 (tetë) vjet burgim.

- Në aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së dënimin e tij përfundimisht me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

**III.** Prishjen e vendimit nr. 60, datë 12.6.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 29, datë 16.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në lidhje me të gjykuarit Elton Haxhiu, Sami Balloku, Astrit Tafaj dhe Aldo Xhaferri.

**IV.** Ky vendim është njësuës dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

**Tiranë, më 24.4.2024**

**Kryesues:** Ilir Panda

**Anëtarë:** Medi Bici, Albana Boksi, Sandër Simoni, Ervin Pupe